

**KONSULTIM ME PUBLIKUN
“DIFERENCIMI DHE TREGTIMI I SKRAPIT E MBETJEVE TE METALEVE TE
RICIKLUESHME”, VORE**

**KONSULTIM ME PUBLIKUN
“DIFERENCIMI DHE TREGTIMI I SKRAPIT E
MBETJEVE TE METALEVE TE
RICIKLUESHME”,
VORE**

*Ligji Nr. 10448/2011, “Per lejet e mjedisit; i ndryshyar
Pika 5. Menaxhimi i mbetjeve
5.5 Magazinim i hekurishteve/skrapeve të metalit që nuk përmbajnë
materiale të rrezikshme
Kapaciteti i barabarte me 50 ton/ditë ose më i madh se kaq.*

ZHVILLUES: METAL -VORA SH.P.K., ME NIPT M32216013V

PASQYRA E LENDES

1. HYRJA

1.1 PERSHKRIMI I PROJEKTIT

1.2 KUADRI LIGJOR DHE ADMINISTRATIV

2. PERSHKRIMI I MBULESES BIMORE TE SIPERFAQES KU PROPOZOHET TE ZBATOHET PROJEKTI

3. INFORMACION PER PRANINE E BURIMEVE UJORE, NE SIPERFAQEN E KERKUAR NGA PROJEKTI DHE NE AFERSI TE TIJ

4. INFORMACION LIDHUR ME IDENTIFIKIMIN E NDIKIMEVE TE MUNDSHME, NEGATIVE, NE MJEDIS, TE PROJEKTIT

5. PERSHKRIMI PER SHKARKIMET E MUNDSHME NE MJEDIT

6. TE DHENA PER SHTRIRJEN E MUNDSHME HAPESINORE TE NDIKIMIT NEGATIV NE MJEDIS

7. MASAT E MUNDSHME PER SHMANGIEN DHE ZBUTJEN E NDIKIMEVE NEGATIVE NE MJEDIS;

8. NDIKIMET E MUNDSHME NE MJEDISIN NDERKUFITAR (NESE PROJEKTI KA NATYRE TE TILLE).

9. PERFUNDIME DHE REKOMANDIME

KONSULTIM ME PUBLIKUN
"DIFERENCIMI DHE TREGTIMI I SKRAPIT E MBETJEVE TE METALEVE TE
RICIKLUESHME", VORE

1. HYRJA

1.1 PERSHKRIMI I PROJEKTIT

Ky raport i konsultimit me publikun do te paraqese nje informacion te shkurter te projektit qe do te realizohet, ndikimet pozitive dhe negative ne mjedis dhe masat qe investitori do te marre per zbatimin e kriterëve te nevojshme per mbrotjen dhe menaxhimin sa me racional te mjedisit.

Theksojme se shume nga vleresimet e detajuara te ndikimeve te mjedisit mbeshteten ne informacionet inxhinierike qe duhet te merren parasysh. Vleresimi identifikon ne menyre te qarte si perfitimet pozitive edhe negative dhe percakton "rezultate te pergjithshme" per secilen prej tyre. Vleresimi identifikon nese ndikimet jane mesatare te pranueshme, te rendesishme, te terthorte apo te drejtperdrejta.

Objekti i kesaj hyrje - permbledhje per raportin e konsultimit me publikun te instalimit ne studim eshte si me poshte vijon:

- Te minimizojë streset ne mjedis dhe ne radhe te pare ne elementet prioritare, si ruajtja e tokes, kontrolli i zhurmave, dhe ruajtja e cilesise se ujit dhe ajrit;
- Te ruaje ose rehabilitoje mjedisin natyror permes elementeve te reja te nderhyrjes pozitive, punimeve te vecanta ne kuader te projektit ose paralel me te, te cilet sigurojne vijueshmerine e qendrueshme te mjedisit biologjik duke perfshire faunen dhe floren ne mjediset perreth zones se marre ne konsiderate.

Vendndodhja e instalimit

Shoqeria METAL -VORA Sh.p.k., me NIPT M32216013V, me administrator Z.Mateo Shanaj do te ushtroje veprimtarine ne sferen grumbullim (proces i cili nuk do te kryhet nga kompania, por vete subjektet do t'i sjellin ne objekt metalet), seleksionim skrapi, metale me ngjyre dhe materiale te riciklueshme me qellim tregtimin ne subjektet ricikluese te tyre.

Aktualisht subjekti ka marre me qira nje magazine, ne formen e kapanonit te mbyllur, i cili do te sherbeje per te magazinuar metalet qe do te mbledhe nga kliente te ndryshem te cilet do t'i sjellin ne magazine. Llojet e metaleve qe do te magazinohen dhe pasi te presohen, do te tregtohen do te jene mbetje skrapi, bakri, bronzi dhe inoksi. Vendndodhja eshte ne Tirane, Fshati Mucaj, Zona Kadastrale Nr.2726 , Numer Pasurie 89/54, Vore, ku do te shfrytezohet siperfaqja 462 m² nga siperfaqja totale e objektit industrial 2300 m².

KONSULTIM ME PUBLIKUN
“DIFERENCIMI DHE TREGTIMI I SKRAPIT E MBETJEVE TE METALEVE TE RICIKLUESHME”, VORE

Siperfaqja e prones: 462 m²

Zona kadastrale: Nr 2726

Numri i pasurise: Nr 89/54

KOORDINATAT

Pika	KRGJSH		GAUSS KRUGER	
	E	N	E	N
1	471460.79	4584347.67	4387957.51	4585291.00
2	471473.21	4584346.38	4387969.92	4585289.57
3	471467.285	4584339.927	4387963.917	4585283.184
4	471474.24	4584345.17	4387970.93	4585288.35



Fig. Planvendosja ku do te zhvillohet aktiviteti

Kontrata e qerase per instalimin paraqitet ne vijim:

KONSULTIM ME PUBLIKUN
“DIFERENCIMI DHE TREGTIMI I SKRAPIT E MBETJEVE TE METALEVE TE
RICIKLUESHME”, VORE



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË

DEGA VENDORE TIRANË

NOTER SHABAN XII. GJOKA
ADRESA Vore Tirane, Rruga Rinia,
Lagja e Re, Pallati Nr.7, Kati I-re,
Dyqani Nr.1
TEL: 692064119



KONTRATË QIRAJE
(PASURI TË PALUAJTSHME)

Nr. repertori: 5057

Nr. koleksioni: 3160

Vore më 23/10/2023

Digitally signed by SHABAN

Ligjet referuese: **GJOKA**

- 1.Ligji nr. 7850, datë 29/07/1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar
- 2.Ligji nr. 9887, date 10/03/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar
- 3.Ligji nr. 110, datë 20/12/2018 "Për Notarinë", i ndryshuar

*Akti noterial përbëhet nga 3 fletë



A2023052380326118799

KONSULTIM ME PUBLIKUN
“DIFERENCIMI DHE TREGTIMI I SKRAPIT E MBETJEVE TE METALEVE TE
RICIKLUESHME”, VORE



KONTRATË QIRAJE

Sot, më datë 23/10/2023, para meje Noter SHABAN XH. GJOKA, anëtar në Dhomën Kombëtare të Noterisë, Dega Vendore TIRANË, me zyrë në adresën Vore, Vore Tirane, Rruga Rinia, Lagja e Re, Pallati Nr.7, Kati I-re, Dyqani Nr.1, u paraqit personalisht:

QIRADHËNËS: **Musa Muça**, atësia Ali, amësia Nurije, shtetas Shqiptar, lindur në Muçaj, Vorë dhe banues në Vorë, me adresë Rruga Muçaj; Nd. 249; Vorë; F/Vorë; 1032; Vorë, lindur më 23/06/1965, gjendja civile “i martuar”, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. 026516265 dhe nr. personal **G50623058N**, (këtu e më poshtë, për efekt të kësaj kontrate do të quhet **Qiradhënësi**).

QIRAMARRËS: **Shoqëria "METAL -VORA" Shpk**, regjistruar si person juridik në QKB, me numër unik identifikimi të subjektit NIUS M32216013V, me adresë Fshati Muçaj, Zona Kadastrale Nr.2726, Numër Pasurie 89/54, Vorë, Tiranë, përfaqësuar nga Administratori Mateo Shanaj, atësia Kristo, amësia Matilda, shtetas Shqiptar, lindur në Vlorë dhe banues në Tiranë, me adresë B.Curri; Nd. 076; Njësia Administrative Nr. 5; Njësia Bashkiake Nr. 5; 1019; Tiranë, lindur më 06/09/2001, gjendja civile “beqar”, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. 034213640 dhe nr. personal K10906055F (këtu e më poshtë, për efekt të kësaj kontrate do të quhet **Qiradhënës**).

Palët kontraktuese me marrëveshje midis tyre, me vullnetin e tyre të lirë e të plotë, deklarojnë se kanë rënë dakord që në bazë të besimit reciprok, kushteve aktuale të tregut dhe legjislacionit civil Shqiptar; e përkatësisht të neneve 801 e vijues të Kodit Civil; të lidhin këtë Kontratë Qiraje (këtej e tutje, “Kontrata”) dhe kërkuan nga unë Noterja hartimin e saj, në përputhje me ligjin, si më poshtë vijon:

OBJEKTI I KONTRATES

Qiradhenesi deklaron dhe garanton se dëshiron t’i jape me qira qiramarrësit pronen Ndertese Provizore sipas Planimetrisë së Godines e ndertuar mbi pronen Token Are me nr pasurije 89/54, zona kadastrale nr 2726, volumi 5, faqe 196, lloji pasurisë toke are me sipërfaqe 2300 (dymije e treqind) m2, prone e ndodhur në fshatin Muçaj, Bashkia Vore, sipas Certifikates së Pronesise, leshuar me date 09.02.1999, leshuar nga Zvrpp Tirane, në emrin e pronarit të pronës zotit **Musa Ali Muça** dhe e nënshkruar nga kryeregjistruesi **Vladimir Pellumbi**.

I lartpërmenduri deklaron se pasurine e mesiperme e ka të pajisur me Çertifikate pronësie dhe është në pronësi të lire nga cdo barre detyrimi apo të drejte reale mbi to.

Prona që jepet me qira është ndertese provizore me sipërfaqe 462,0 m2, e ndertuar mbi pronen me nr pasurije 89/54, me sipërfaqe totale 2300 m2 dhe do të perdoret për nevoja Biznesi për magazine.

AFATI KONTRATES

Afati i kësaj Kontrate Qiraje është për një periudhë kohe 1 (një)vjeçare. Afati i marrëdhënieve kontraktuese mes paleve daton nga data 23.10.2023 dhe perfundon me date 22.10.2024. Me pelqimin dhe dakortesine e dy paleve, kjo kontrate mund të zgjatet edhe tej afatit të percaktuar.

VLERA E QERASE DHE KUSHTET E PAGESES

Fq. 1

KONSULTIM ME PUBLIKUN
“DIFERENCIMI DHE TREGTIMI I SKRAPIT E MBETJEVE TE METALEVE TE
RICIKLUESHME”, VORE

Qellimi i aktivitetit: Pergatitja e mbetjeve te metaleve per riciklim. Aktiviteti perfshihet ne kategorine “11. Projekte te tjera, Pika d) Depot e skrapit te hekurit, perfshire ato nga automjetet” te Shtojces I te Ligjit Nr. 10 440, date: 07.07.2011. **Theksojme se ne kete instalim nuk do te grumbullohen mbetje te automjeteve, por vetem metale skrap, inoks, bronx, baker, te cilat do te sillen nga subjekte ne instalim dhe me pas do te terhiqen nga subjekte te licencuara per trajtimin e metejshem te tyre.**

Organizimi i truallit te marre me qera eshte ne funksion te procedures se kesaj veprimtarie (teknologjise), ka ambientet ndihmese, ambienti i pranimit ku eshte vendosur peshorja; ambienti i seleksionimit sipas llojit te metaleve, ambienti i presimit ku eshte vendosur nje prese.

Pajisjet/ makinerite qe do te perdoren jane :

- peshorja,
- presa,
- vinc pirun per levizjen e materialit.

Kapaciteti grumbullues per metalet e skrapit, bakrit, bronzit, inoksit eshte 50 ton/dite.

Mbetjet qe do te pranohen ne instalimin e “Metal Vora” Sh.p.k., referuar VKM nr. 99/2005 “Per miratimin e katalogut shqiptar te mbetjeve”, i perkasin kategorive si me poshte vijon:

19 12 02 Metale ferore

19 12 03 Metale jo-ferore

Lendet ndihmese: uje per larje sheshe, higjeno sanitar dhe energji elektrike

Konkretisht aktiviteti do te kryeje keto procese: Pranimi dhe peshimi i materialit te ardhur seleksionimi (ndarja e tyre sipas llojit te metalit) Perpunimi i materialit qe nenkupton presimin ne prese dhe me pas duke e paketuar ne paleta per t’u tregetuar ne subjekte qe realizojne riciklimin e tyre.

Veprimtaria kryhet me nje turn 8 ore/ dite.

Skema teknologjike e aktivitetit jepet ne vijim, ku hallka qe do te realizohet ne instalimin e “Metal Vora” Sh.p.k. eshte procesi i grumbullimit dhe presimit (hallka qe i paraprin riciklimit nga subjektet e licencuara, pra pergatitja per riciklim).

KONSULTIM ME PUBLIKUN
“DIFERENCIMI DHE TREGTIMI I SKRAPIT E MBETJEVE TE METALEVE TE RICIKLUESHME”, VORE



Fig. Hallkat e riciklimit te metaleve




Fig. Skema teknologjike e aktivitetit

- Gjendja ekzistuese

Zona eshte e pergatitur per funksionim dhe do te filloje fazen operacionale pas pajisjes me leje mjedisi tip B.

Trualli ne te cilin kompania do te zhvilloje kete aktivitet, eshte nje truall i ndertuar, dhe ambientet e jashtme jane te shtruara. Pra zhvillimi i aktivitetit nuk prek bimesine e zones. Gjithashtu perreth objektit ndodhen aktivitet industriale dhe tregtare.

Instalimi gjendet ne nje objekt industrial ne Vore, ku eshte marre me qera siperfaqja 462m² nga siperfaqja totale 2300m² e objektit. Objekti eshte ekzistues dhe nuk do te kryhen punime ndertimi, por vetem do te instalohen pajisjet e nevojshme per fillimin e veprimtarise (aktiviteti do te vendoset ne funksion pas pajisjes me leje mjedisi).

Zona eshte terren i sheshte, ben pjese ne zone jo shume te banuar, dhe eshte nje nder zonat per zhvillim industrial. Sheshi ka formen e nje katerkendeshi te rregull. Ka rrethim mur blloku me infrastrukture te rregullt si ne aspektin e ujesjelles kanalizimeve ashtu dhe te furnizimit me energji elektrike.

KONSULTIM ME PUBLIKUN
“DIFERENCIMI DHE TREGTIMI I SKRAPIT E MBETJEVE TE METALEVE TE
RICIKLUESHME”, VORE

Me poshte paraqiten foto nga gjendja ekzistuese e zones se marre ne studim:



KONSULTIM ME PUBLIKUN
“DIFERENCIMI DHE TREGTIMI I SKRAPIT E MBETJEVE TE METALEVE TE
RICIKLUESHME”, VORE



Fig. Foto nga gjendja ekzistuese e zones se marre ne studim

1.2 KUADRI LIGJOR DHE ADMINISTRATIV

Procesi i hartimit te Vleresimit te Ndikimit ne Mjedis (VNM), ndihmon ne permiresimin e cdo lloj projekti ne respektimin dhe mbrojtjen maksimale te mjedisit te zones ku ai zbatohet.

Qellimi i VNM-se eshte qe te siguroje qe mjedisi ne zonen ku zbatohet projekti do te konsiderohet i lidhur me gjithë ceshtjet e tjera te rëndesishme, ne cdo etape te tij.

Ky raport eshte hartuar bazuar ne legjislacionin mjedisor ne fuqi dhe ka per qellim te identifikojë, parashikojë dhe vleresojë gjithë ndikimet e mundshme ne menyre sistematike, te kuptueshme dhe objektive.

VNM-ja eshte vleresimi mjedisor ne nje proces vleresimesh (te mjedisit, planifikimit hapesor, ndertimit, etj.) qe eventualisht mund te finalizohet me Lejen e Zhvillimit.

Vleresimi i Ndikimit ne Mjedis ne fakt i pergjigjet ne thelb ketyre pyetjeve kyc:

A. Si do te ishte mjedisi pa projektin? (per shembull Studimet Baze). Kjo do te identifikojë dhe pershkruajë gjendjen aktuale te burimeve dhe karakteristikat

KONSULTIM ME PUBLIKUN
“DIFERENCIMI DHE TREGTIMI I SKRAPIT E MBETJEVE TE METALEVE TE
RICIKLUESHME”, VORE

ekzistuese ne mjedisin qe mund te ndikohet nga projekti dhe se si keto do te zhvillohen ne mungese te projektit.

- B. Cfare do t'i ndodhe ne mjedisit, si pasoje e projektit?** (per shembull Parashikimi). Kjo do te pershkruaje mjedisin sic eshte pa projektin dhe se si ai do te ndryshoje si pasoje e projektit ne aspektin e burimeve mjedisore apo njerezve (receptoret) qe jane te ndikuar, natyren dhe shkallen e ndryshimit, shtrirjen e tij gjeografike dhe kohore.
- C. A perben kjo nje shqetesim?** (per shembull Vleresimi) Parashikimi i ndikimit nuk eshte i mjaftueshem.
- D. Nese eshte i rendesishem a mund te bejme ndonje gje ne lidhje me te?** (per shembull Zbutja). Se fundi, eshte e rendesishme te kuptohet se, ne qofte se ndikimi eshte i rendesishem, mund te behet dicka per te shmangur, reduktuar, korrigjuar apo kompensuar per te. Zhvilluesi i projektit mund t'i perfshije keto masa zbutese ne propozime te projektit dhe autoriteti kompetent mund t'i perfshije kerkesat perkatese ne kushtet e lejes se dhene.

Ne menyre qe autoritetet kompetente dhe palete jashtmete interesuara te vendosin nese projekti duhet te vazhdoje, eshte thelbesore qe informacioni mjedisor i dhene nga zhvilluesi ne Raportin e VNM-se, t'i pergjigjet ne menyre te qarte pyetjeve te mesiperme. Qellimi i studimeve te VNM eshte qe te gjeneroje dhe paraqese kete informacion ne menyre te qarte, koherente dhe te sakte.

Idea e VNM-se eshte te siguroje informacion per vendim marresit dhe publikun mbi pasojat mjedisore te zhvillimeve te reja te propozuara. Per me teper ideja eshte qe te promovohet zhvillimi qe respekton mjedisin permes identifikimit te masave te duhura forcuese dhe zbutese.

Objektivi kryesor i VNM-se eshte te identifikojte ndikimet e mundshme negative mjedisore te projekteve te reja te zhvillimit. Brenda ketij qellimi, procesi i VNM-se kerkon qe:

- te konsiderohen alternativat per vendndodhjen dhe ndikimet mjedisore shoqeruese;
- te permiresohet plani mjedisor i propozimit;
- te sigurohet qe burimet jane perdorur si duhet dhe ne menyre eficente;
- te identifikohen masat e duhura per zbutjen e ndikimeve te mundshme te propozimit;
- te vendosen kushtet per ndertimin; dhe
- te ndihmohet vendim marrja dhe informimi i publikut.

Procedura e VNM-se perfshin:

- a. procesin paraprak te VNM-se;

KONSULTIM ME PUBLIKUN
“DIFERENCIMI DHE TREGTIMI I SKRAPIT E MBETJEVE TE METALEVE TE
RICIKLUESHME”, VORE

b. procesin e thelluar te VNM-se.

Agjencia Kombetare e Mjedisit (AKM) shyrton kerkesat per vleresimin e ndikimit ne mjedis dhe ne fund te seciles procedure, paraprake apo te thelluar te VNM-se, merr Vendimin per VNM-ne paraprake, ndersa per VNM-ne e thelluar pergatit Deklaraten Mjedisore me rekomandimet perkatese dhe i'a degon Ministrise.

Ne perfundim vendim marrja konsiston ne:

- Vendim - leshuar nga AKM-ja ne perfundim te procedures paraprake te VNM-se
- Deklarate Mjedisore - leshuar nga Ministri ne perfundim te procedures se thelluar te VNM-se

Vendimi

Vendimi i AKM-se ne fund te procedures Paraprake te VNM-se percakton nese nje projekt i listuar ne Shtojcen II te Ligjit per Vleresimin e Ndikimit ne Mjedis, ne fuqi, duhet apo jo t'i nenshtrohet procedures se thelluar te VNM-se. Nese AKM-ja vendos se projekti nuk duhet t'i nenshtrohet procedures se thelluar te VNM-se, ne vendimin e saj percakton arsyet dhe konsideratat kryesore ku eshte mbeshtetur mendimi, mendimin e institucioneve te konsultuara, pershkrimin sipas rastit, te masave kryesore qe duhen marre per te shmangur, reduktuar dhe nese eshte e mundur per te korrigjuar ndikimet negative te mundshme ne mjedis.

Deklarata Mjedisore

Rezultati perfundimtar i procedures se thelluar te VNM-se, eshte Deklarata Mjedisore, e cila mund te permbaje refuzimin ose miratimin me rekomandime per Autoritetin e Planifikimit per te vazhduar procesin ne baze te kushteve te specifikuara mjedisore. Deklarata mjedisore sherben si dokument orientues per Autoritetin e Planifikimit dhe/ose cdo autoritet pergjegjes ne procesin e vendim marrjes, per nje leje zhvillimi apo per nje leje te caktuar per miratimin e nje projekti te listuar ne Shtojcat 1 dhe 2 te ligjit per Vleresimin e Ndikimit ne Mjedis, ne fuqi.

Dokument i baze ku mbeshtetet procesi i VNM-se, eshte raporti i vleresimit te ndikimit ne mjedis, i cili ne varesi te ndikimeve te mundshme te projektit mund te jete:

- a. raport paraparak i VNM-se per projektet e shtojces II te ligjit nr. 10440, date 07.07.2011'Per vleresimin e ndikimit ne mjedis' te ndryshuar;
- b. raport i thelluar i VNM-se per projektet e shtojces I te ligjit nr. 10440, date 07.07.2011'Per vleresimin e ndikimit ne mjedis' te ndryshuar.

KONSULTIM ME PUBLIKUN
“DIFERENCIMI DHE TREGTIMI I SKRAPIT E MBETJEVE TE METALEVE TE
RICIKLUESHME”, VORE

Baza ligjore

1. Ligji nr. 10431, date 09.06.2011 ‘Per mbrojtjen e mjedisit’, te ndryshuar;
2. Ligji nr. 10440, date 07.07.2011 ‘Per vleresimin e ndikimit ne mjedis’, te ndryshuar;
3. Ligji nr.10006, date 23.10.2008 “Per mbrojtjen e faunes se eger”
4. Ligji nr. 8906, date 6.6.2002 “Per zonat e mbrojtura” ndryshuar me ligjin, Nr. 9868, date 4.2.2008 “Per disa shtesa dhe ndryshime ne ligjin nr.8906 date 6.6.2002 “Per zonat e mbrojtura”
5. Ligi nr. 10 253, date 11.3.2010 “Per gjuetine”
6. Ligji Nr. 9533, date 15.5.2006 Per disa ndryshime ne Ligjin Nr. 9385, date 4.5.2005 "Per pyjet dhe sherbimin pyjor"
7. Ligji Nr. 9791, date 23.7.2007 Per disa ndryshime ne Ligjin Nr. 9385, date 4.5.2005 "Per pyjet dhe sherbimin pyjor"
8. Ligji Nr. 15/2012, Per disa ndryshime dhe shtesa ne Ligjin Nr. 9385, date 4.5.2005 "Per pyjet dhe sherbimin pyjor"
9. Ligji Nr. 36/2013, Per disa ndryshime dhe shtesa ne Ligjin Nr. 9385, date 4.5.2005 "Per pyjet dhe sherbimin pyjor"
10. Ligji Nr. 38/2013 Per disa ndryshime ne Ligjin Nr. 9693, date 19.03.2007 "Per fondin kullosor te ndryshuar"
11. Ligji Nr. 9385, date 4.5.2005 "Per pyjet dhe sherbimin pyjor"
12. Ligji nr. 68/2014 “Per disa shtesa dhe ndryshime ne ligjin nr. 9587, date 20.7.2006, “Per mbrojtjen e biodiversitetit”, te ndryshuar.
13. Ligji nr. 162/2014 "Per mbrojtjen e cilesise se ajrit ne mjedis"
14. VKM nr. 686, date 29.07.2015 ‘Per miratimin e rregullave, te pergjegjesive e te afateve perzhvillimin e procedures se vleresimit te ndikimit ne mjedis(VNM) dhe procedures se transferimit te vendimit dhe deklarates mjedisore’;
15. VKM nr. 247, date 30.04.2014 “Per percaktimin e rregullave, te kerkesave e te procedurave per informimin dhe perfshirjen e publikut ne vendimmarrjen mjedisore”
16. Ligji nr. 10 463, date 22.9. 2011”Per menaxhimin e integruar te mbetjeve”, te ndryshuar;
17. VKM nr. 575 date 24.06.2015 “Per miratimin e kerkesave per menaxhimin e mbetjeve inerte”
18. VKM nr.175, date 19.1.2011 “Per miratimin e strategjise kombetare te menaxhimit te mbetjeve dhe te planit kombetar te menaxhimit te mbetjeve”
19. VKM nr. 371, date 11.06.2014 “Per percaktimin e rregullave per dorezimin e mbetjeve te rrezikshme dhe miratimin e dokumentit te dorezimit te mbetjeve te rrezikshme”
20. VKM Nr. 765, date 7.11.2012 “Per miratimin e rregullave per grumbullimin e diferencuar dhe trajtimin e vajrave te perdorura”

KONSULTIM ME PUBLIKUN
“DIFERENCIMI DHE TREGTIMI I SKRAPIT E MBETJEVE TE METALEVE TE
RICIKLUESHME”, VORE

21. VKM nr. 418, date 25.06.2014 “Per grumbullimin e diferencuar te mbetjeve ne burim”
22. VKM nr. 229, date 23. 04. 2014 “Per miratimin e rregullave per transferimin e mbetjeve jo te rrezikshme dhe te dokumentit te transferimit te mbetjeve jo te rrezikshme”
23. VKM nr. 519, date 30.6.2010 “Parqet Natyror Rajonal”
24. Vendim Nr. 22, date 9.1.2008 "Per caktimin e procedurave dhe te kritereve te administrimit te pyllit komunal"
25. Vendim Nr. 1354, date 10.10.2008 "Per rregullat dhe procedurat qe ndiqen per heqjen, shtimin dhe ndryshimin e destinacionit te fondit kullisor"
26. Vendim Nr. 396, date 21.06.2006 "Per kriteret e transferimit dhe te perdorimit te pyjeve nga njesite e qeverisjes vendore"
27. VKM nr.897. date 21.2.2011 “Miratimi i Rregullave per Shpalljen e Zonave te Vecanta te Ruajtjes”
28. VKM nr. 532, date 05.10.2000 “Per miratimin e studimit “Strategjia dhe Plani i veprimit per biodiversitetin”
29. VKM nr. 676, date 20.12.2002 “Per shpalljen zone e mbrojtur te monumenteve te natyres shqiptare”
30. VKM nr. 594, date 10.09.2014 "Per miratimin e Strategjise Kombetare per cilesine e ajrit te mjedisit"
31. Vendimi Nr. 435, date 12.9.2002 “Per miratimin e normave te shkarkimeve ne ajer ne Republiken e Shqiperise”
32. VKM nr 352, date 29.04.2015. “Per vleresimin e cilesise se ajrit te mjedisit dhe kerkesat per disa ndotes ne lidhje me te” .

Objekt i ligjit per Vleresimin e Ndikimit ne Mjedis, eshte percaktimi i kerkesave, pergjegjesive, rregullave dhe procedurave per vleresimin e ndikimeve te rendesishme negative mjedisore te projekteve te propozuara, private ose publike.

Sipas ligjit Per Mbrojtjen e Mjedisit, vleresimi i ndikimit ne mjedis i nje projekti te propozuar zhvillimi eshte vleresimi i ndikimeve te rendesishme, te mundshme te asaj veprimtarie ne mjedis.

Gjate procesit te vleresimit te ndikimit ne mjedis, kryhen identifikimi, pershkrimi dhe vleresimi ne menyren e duhur i ndikimit ne mjedis te nje veprimtarie, duke percaktuar efektet e mundshme te drejtperdrejta dhe jo te drejtperdrejta mbi token, ujin, detin, ajrin, pyjet, klimen, shendetin e njeriut, floren dhe faunen, peizazhin natyror, pasurite materiale, trashegimine kulturore, duke pasur parasysh lidhjet e tyre te ndersjella.

KONSULTIM ME PUBLIKUN
“DIFERENCIMI DHE TREGTIMI I SKRAPIT E MBETJEVE TE METALEVE TE
RICIKLUESHME”, VORE

Vleresimi i ndikimit ne mjedis zbaton parimin e parandalimit qe ne fazen e hershme te planifikimit te projektit, me qellim shmangien apo minimizimin e efekteve negative ne mjedis, permes harmonizimit dhe pershtatjes se saj me kapacitetin bartes te mjedisit.

Vleresimi i ndikimit ne mjedis kryhet nga zhvilluesi, si pjese e pergatitjeve per planifikimin e nje projekti zhvillimi dhe para kerkimit te lejeve perkatese te zhvillimit.

Ligji per Vleresimin e Ndikimit ne Mjedis, dhe aktet nenligjore qe rrjedhin prej tij, te parafruara plotesisht me Direktiven e bashkimit Evropian per Vleresimin e Ndikimit ne Mjedis ka per qellim te siguroje nje nivel te larte te mbrojtjes se mjedisit, permes parandalimit, minimizimit dhe kompensimit te demeve ne mjedis, nga projekte te propozuara para miratimit te tyre per zhvillim dhe garantimin e nje procesi te hapur vendimmarrjeje, gjate identifikimit, pershkrimimit dhe vleresimit te ndikimeve negative ne mjedis, ne menyren dhe kohen e duhur si dhe perfshirjen e te gjitha paleve te interesuara ne te.

Ky ligj zbatohet per projektet e propozuara, private apo publike, te cilat mund te shkaktojne ndikime te rendesishme negative, te drejtperdrejta ose jo, ne mjedis, si pasoje e madhesise, natyres apo vendndodhjes se tyre.

Kerkesa te pergjithshme per vleresimin e ndikimit ne mjedis te nje projekti:

- Vleresimi i ndikimit ne mjedis perfshin percaktimin, pershkrimin dhe vleresimin e ndikimeve te pritshme te drejtperdrejta e jo te drejtperdrejta mjedisore te zbatimit apo moszbatimit te projektit.
- Ndikimet mjedisore te projektit vleresohen ne lidhje me gjendjen e mjedisit ne territorin e prekur ne kohen e paraqitjes se raportit perkates per vleresimin e ndikimit ne mjedis te projektit.
- Vleresimi i ndikimit ne mjedis perfshin pergatitjen, zbatimin, funksionimin dhe mbylljen e tij, sipas rastit, edhe pasojat e mbylljes se veprimtarise, dhe dekontaminimin/pastrimin apo rikthimin e zones ne gjendjen e meparshme, nese nje detyrim i tille parashikohet me ligj. Vleresimi perfshin, sipas rastit, si funksionimin normal, ashtu edhe mundesine per aksidente.
- Vleresimi i projektit perfshin, gjithashtu, propozimin e masave te nevojshme per parandalimin, reduktimin, zbutjen, minimizimin e ndikimeve te tilla ose rritjen e ndikimeve pozitive mbi mjedisin, gjate zbatimit te projektit, perfshire edhe vleresimin e efekteve te pritshme te masave te propozuara.

KONSULTIM ME PUBLIKUN
“DIFERENCIMI DHE TREGTIMI I SKRAPIT E MBETJEVE TE METALEVE TE
RICIKLUESHME”, VORE

Aspektet me te rendesishme te procesit paraprak te VNM-se, jane konsultimet me palet e tjera dhe vendimi nese kerkohej nje VNM e thelluar.

VNM paraprak eshte faza e pare e procesit te VNM. Sipas Nenit 8 te ligjit te VNM qellimi i VNM Paraprak eshte te identifikoje propozimet qe kerkojne VNM te thelluar. VNM Paraprak perjashton nga procesi ato propozime (shumicen) qe nuk kane ndikime te rendesishme, ose pak, ndikime lehtesisht te kontrollueshme, dhe per te cilat VNM eshte e panevojshme. Ne vijim, Tabelat dhe Listat e Kontrollit do te ndihmojne ne procesin i cili vendos nese kerkohej VNM per nje projekt te vecante ose tip projekti.

Tre fazat kryesore e VNM Paraprak jane:

- **Paraqitja e kerkeses** dhe dokumentacionit shoqerues nga zhvilluesi ne Ministrine e Mjedisit, kontrolli administrativ paraprak i aplikimit nga Ministria e Mjedisit dhe percjellja e tyre nga Ministria ne Agjencine Kombetare te Mjedisit (AKM);
- Kontrolli teknik **paraprak** ibere nga AKM dhe **konsultimi** i AKM **me insitucionet e tjera** dhe **publikimi** i aplikimit;
- AKM njofton per **vendimin e marre**, nese projekti eshte apo jo e nevojshme ti nenshtrohet procedures se thelluar te VNM, Ministrine e Mjedisit (MM) dhe palet e perfshira ne proces, dhe publikon vendimin ne faqen e internetit te AKM.

Konventat dhe marrveshjet nderkombetare ne lidhje me procesin e VNM-se

Direktiva e Këshillit të BE-së 97/11/EC e cila modifikoi Direktivën 85/337/EEC mbi Vlerësimin e Disa Projekteve Publike e Private, parashikon qe autoritetet kompetente të shteteve anëtare të kërkojnë kryerjen e një vlerësimi të ndikimit mjedisor (VNM) për projektet që mund te rezultojne me ndikim domethënës në mjedis. VNM duhet të pergatitet para miratimit të projektit, në mënyrë që vendimi për miratim të marre paraysh ndikimet e mundshme të projektit në mjedis. Direktiva paraqet një listë të projekteve që kërkojnë studimin e VNM në të tëra rastet (Shtojca 1) dhe një listë të projekteve që mund të kërkojnë një studim të permblendhur VNM (Shtojca 2), në varësi të një vlerësimi per ndikimet e mundshme qe mund te rezultojne nga projekti i propozuar apo te kriterave kufizuese, të vendosura nga secili shtet anëtar. Propozimi aktual konsiderohet si një projekt i Shtojcës 2.

Direktiva kërkon që “VNM të identifikojë, përshkruajë e vlerësojë në mënyrën e duhur ndikimet e drejtpërdrejta e indirekte të një projekti per:

- Qëniet njerëzore, floren dhe faunen;
- Token, ujin, klimen dhe peizazhin;
- Asetet materiale te trashëgimia kulturore; dhe
- Ndërveprimin midis faktorëve të lartpërmendur.

Informacioni tjetër qe percaktohet ne direktive qe duhet te përfshihen në studimin e VNM-se jepet në Shtojcën IV të Direktivës 97/11/EC dhe ajo përfshin:

- një përshkrim të projektit;

KONSULTIM ME PUBLIKUN
“DIFERENCIMI DHE TREGTIMI I SKRAPIT E MBETJEVE TE METALEVE TE
RICIKLUESHME”, VORE

- një përvijim të alternativave kryesore të vendodhjes dhe të teknologjise të marra në shqyrtim për projektin e propozuar;
- një përshkrim të aspekteve të mjedisit që mund të ndikohen me shumë nga projekti e që lidhen me popullsinë, florën, faunën, tokën, ujin, faktorët klimatik, asetet materiale, pejsazhin e raportin reciprok mes faktorëve të lartpërmendur;
- një përshkrim të ndikimeve domethënëse të projektit që dalin në pah nga ekzistenca e vetë projektit, shfrytëzimi i burimeve natyrore, cilrimi/shkarkimi i lëndëve ndotëse, krijimi i zhurmave dhe trajtimi i mbetjeve;
- një përshkrim i masave të parashikuara për parandalimin, uljen dhe aty ku është e mundur, mënjanimin e efekteve të dëmshme në mjedis; dhe
- një përmbledhje jo-teknike e informacionit të siguruar.

Direktiva 97/11/EC (amenduar nga Direktiva 2003/35/EC pas nënshkrimit të Konventës së Aarhus nga Komuniteti, më 25 Qershor 1998, mbi pjesëmarrjen e publikut në vendim-marrje dhe akses në vendosjen e drejtësisë në çështjet mjedisore) gjithashtu parashikon konsultimin me publikun, në fazën e propozimit e mbledhjes së informacionit, për t'i dhënë publikut të interesuar mundësinë për të shprehur mendimin e tyre para marrjes së vendimit lidhur me zhvillimin e propozuar.

Shqipëria është anetare dhe ndjek detyrimet e konventave të mëposhtme nderkombetare:

- Konventa e Bernit (CH) “Për mbrojtjen e flores dhe faunes së eger dhe mjedisin e saj natyror në Evropë.”, miratuar me ane të ligjit nr 8690, më 2 Mars 1998;
- Konventa e Barcelonës “Për mbrojtjen e mjedisit detar dhe ujor të Mesdheut” dhe protokollet e saj;
- Konventa e Bonit “Mbi mbrojtjen e faunes së eger shtegtare”;
- Konventa e Vienes “Mbi kontrollin e kalimit kufitar të mbetjeve të rrezikshme dhe asgjësimin e tyre”, miratuar me ane të ligjit nr. 8216, më 13 Prill 1997;
- Konventa e Vienes “Për mbrojtjen e shtresës së Ozonit” dhe protokollin i Montrealit “Mbi substancat që demtojnë shtresën e Ozonit”;
- Konventa e Aarhusit “Mbi të drejtën e publikut për t’u informuar, për pjesëmarrje në vendim-marrje dhe e drejta për t’iu drejtuar organeve të drejtësisë për çështjet mjedisore”, miratuar me ligjin nr. 8672, më 26 Tetor 2000;
- Konventa “Vlerësimi i Ndikimit në Mjedis në kuadrin Nderkombëtar”. Hyr në fuqi më 4 Tetor 1991;
- Konventa e Kombeve të Bashkuara mbi Ndryshimet Klimatike, Tetor 1994;
- Konventa e Kombeve të Bashkuara mbi Biodiversitetin, Janar 1994;
- Kombet e Bashkuara “Konventa kundër zgjerimit të shkretëtirave në vendet e thata, vecanerisht në Afrikë”. Hyrja në fuqi më 27 Prill 2000.

KONSULTIM ME PUBLIKUN
“DIFERENCIMI DHE TREGTIMI I SKRAPIT E MBETJEVE TE METALEVE TE
RICIKLUESHME”, VORE

2. PERSHKRIMI I MBULESES BIMORE TE SIPERFAQES KU **PROPOZOHET TE ZBATOHET PROJEKTI**

Biodiversiteti

Rajoni i bashkise se Vores shtrihet ne zonen e Ultesires Perendimore dhe nga pikepamja biogeografike perfshihet ne katin e shkorreteve mesdhetare dhe makjeve. Klima e zones klasifikohet si mesdhetare fushore, qe karakterizohet nga nje vere e nxehte dhe e thate dhe dimer i bute dhe i lagesht. Mesatarja vjetore e temperaturave eshte 15 - 16°C ndersa reshjet luhaten midis 950 - 1200 mm shi ne vit. Territori i bashkise shtrihet me se shumti ne relief kodrinor te ulet, ne mes te vargut kodrinor Kepi i Rodonit - Vore - Ndroq, i cili ndan rajonin e Tiranes me ate te Durresit dhe pellgun ujembledhes te Ishmit nga ai i Erzenit. Lartesite mbizoteruese jane Kodra e Gerdecit (295 m) ne veri dhe Kodra e Kucit (400 m) ne jug. Elementet me te theksuar hidrografike natyrore jane perroi i Gerdecit dhe i Gjokajt ndersa elementet artificiale perfshijne nje sere rezervuaresh (Gjokaj, Picar, Marikaj, Beroxull) dhe kanalin ujites qe pershkron gjithnje luginen Beroxull-Marikaj.

Bimesia - speciet floristike

Ne saje te vendndodhjes gjeografike dhe elementeve natyrore, zona e Vores ka nje larmi biologjike me te larte se rajoni perreth, dhe eshte e karakterizuar nga nje mbulesa bimore natyrore nderthurur me peizazhe rurale antropogjenike. Bimesia natyrore mbizoteruese jane shkorretet mesdhetare, te njohura si formacionet e makjes (*Maquis*) ku verehet prania tipike e shqopes (*Erica arborea*), marese (*Arbutus unedo*), xines (*Pistacia lentiscus*), gjineshtres (*Genista sp.*), dellinjes (*Juniperus communis*), frasherit (*Fraxinus sp.*) si edhe ne lartesite me te medha kodrinore formacionet e dushkut (*Quercus sp.* me mbizoterim te *Quercus cerris*). Pergjate perrenjve dhe rrjedhave ujore hasen shelgu (*Salix sp.*) dhe plepi (*Populus alba*). Gjithashtu ne zone vihet re prezenca e ullirit te eger dhe atij te kultivuar (*Olea oleaster* dhe *Olea europea*) te cilet perbejne nje element te theksuar peisazhistik pertej kontekstit natyror pasi bartin dhe vlere historiko-kulturore, te lidhura ngushte me zhvillimin rural te zones.

Nje pjese e madhe e mbuleses vegjetative perbehet nga pyje te degraduara ose ne rigjenerim e siper, pasi kane vuajtur shfrytezime pa kriter ne vitet e fundit dhe shume jane ende nen presionin e vazhdueshem njerezor (prerje, kullotje, etj.). Pyjet e larta jane te rralla dhe gjurme te tyre mund te hasen vetem ne zonen e kodrave te Kucit ne jug dhe te Gerdecit ne veri. Si rezultat i shfrytezimit pa kriter te pyjeve dhe bimesise se zones ne vende te ndryshme vihet re nje tjetersim i peisazhit dhe shfaqje masive e fenomenit te erozionit, qe ne disa pika (mbi rezervuarin e Gjokajt, rreth fshatit Gerdec)

KONSULTIM ME PUBLIKUN
“DIFERENCIMI DHE TREGTIMI I SKRAPIT E MBETJEVE TE METALEVE TE RICIKLUESHME”, VORE

eshte tejet aktiv dhe ka arritur ne shfaqjen e shkembinjve baze. Kullotja e vazhdueshme dhe prerjet per dru zjarri, pa kriter dhe planifikim nga banoret e zones jane fenomene demtuese te vazhdueshme per bimesine e zones dhe faktore limitues per rigjenerimin e pyjeve.

Flora dhe fauna perbejne nje komponent te rendesishem te peizazhit natyror te nje vendi. Ato kane rendesi te madhe ekonomike, mjedisore dhe ekologjike. Ne zonen e perzgjedhur nuk ka ndonje lloj ose specie flore apo faune qe mbrohet me status te vecante. Ashtu sikurse vihet re nga harta e meposhtme (burimi: ASIG), zona ne studim klasifikohet si komerciale/ industriale.




Fig. Mbulesa e tokes e zones ne studim

Fauna

Zona e Vores ka nje faune tipike te rajoneve rurale dhe antropogjenike si edhe te lidhur me habitatet e ndikuara nga veprimtaria e njeriut. Nga gjitaret, llojet me te hasura jane dhelpra (*Vulpes vulpes*) dhe lepuri i eger (*Lepus europaeus*), shenja te te cileve u identifikuan shpesh gjate vizitave ne terren. Gjithashtu ne zone hasen lloje te familjes se mustelideve si nuselala (*Mustela nivalis*), kunadhja (*Martes foina*) dhe baldosa (*Meles meles*) si edhe prania e mundshme e cakallit (*Canis aureus*). Ne rezervuaret e shumte te

KONSULTIM ME PUBLIKUN
“DIFERENCIMI DHE TREGTIMI I SKRAPIT E MBETJEVE TE METALEVE TE
RICIKLUESHME”, VORE

zones (Gjokaj, Picar, Marikaj, Gerdec) eshte e mundur prania e lunderzes (*Lutra lutra*) edhe pse shenja te saj nuk u identifikuan gjate ekspeditave ne terren. Nder gjitaret e vegjel te pranishem ne zone permendim ketrin (*Sciurus vulgaris*), iriqin (*Erinaceus concolor*), urithin (*Talpa caeca*), hundegjatet (*Crocidura suaveolens*, *Crocidura leucodon*), gjerin e lajthise (*Muscardinus avellanarius*), dhe lloje te ndryshme minjsh (*Muridae*). Gjithashtu ne zone hasen disa lloje lakuriqesh nate.

Bazuar ne pozicionin gjeografik te zones, kushtet klimatike, llojet e habitateve si edhe kerkimeve ne terren, llojet e gjitareve te zones se Vores jane paraqitur ne tabelen e meposhtme:

Lloji	Prania	Emri shqip
RENDI INSECTIVORA		
Fam. Erinaceidae		
<i>Erinaceus concolor</i>	P	Iriqi
Fam. Talpidae		
<i>Talpa caeca</i>	P	Urithi i verbër
Fam. Soricidae		
<i>Suncus etruscus</i>	?	Hundgjatë i vogël dhëmbëbardhë
<i>Crocidura suaveolens</i>	P	Hundgjatë i kopshteve
<i>Crocidura leucodon</i>	P	Hundgjatë i livadheve
RENDI CHIROPTERA		
Fam. Rhinolophidae		
<i>Rhinolophus blasii</i>	P?	Lakuriq nate hund-patkua i Blausius-it
<i>Rhinolophus euryale</i>	P?	Lakuriq nate hund-patkua i Mesdheut
<i>Rhinolophus ferrumequinum</i>	P?	Lakuriq nate hund-patkua i madh
<i>Rhinolophus hipposideros</i>	?	Lakuriq nate hund-patkua i vogël
Fam. Vespertilionidae		
<i>Miniopterus schreibersi</i>	P?	Lakuriq nate i Schreiber-it
<i>Myotis blythi</i>	P	Lakuriq nate vesh miu i vogël
<i>Myotis myotis</i>	P	Lakuriq nate vesh miu i madh
<i>Myotis mystacinus</i>	P?	Lakuriq nate me mustaqe
<i>Nyctalus leisleri</i>	P?	Lakuriq nate i Leisler-it
<i>Nyctalus noctula</i>	P?	Noktule
<i>Pipistrellus pipistrellus</i>	P	Pipistrelli i zakonshëm
<i>Plecotus auritus</i>	P?	Lakuriq nate veshëgjatë i zakonshëm
<i>Plecotus austriacus</i>	P?	Lakuriq nate vesh-gjatë i hirtë
RENDI LAGOMORPHA		
Fam. Leporidae		
<i>Lepus europaeus</i>	P	Lepur i murmë
Fam. Sciuridae		
<i>Sciurus vulgaris</i>	P	Ketri
Fam. Gliridae		
<i>Muscardinus avellanarius</i>	P	Gjumashi i lajthisë

KONSULTIM ME PUBLIKUN
“DIFERENCIMI DHE TREGTIMI I SKRAPIT E MBETJEVE TE METALEVE TE
RICIKLUESHME”, VORE

Fam. Muridae		
Microtinae		
<i>Arvicola terrestris</i>	?	Miu i ujrave
<i>Microtus felteni</i>	P?	Miu i Felten-it
<i>Microtus thomasi</i>	P?	Miu i lajthisë
Murinae		
<i>Apodemus flavicollis</i>	?	Miu i ujrave
<i>Apodemus mystacinus</i>	P?	Miu i shkëmbit
<i>Apodemus sylvaticus</i>	P?	Miu bisht-gjatë
<i>Micromys minutus</i>	P	Miu i të korrave
<i>Mus musculus</i>	P	Miu i shtëpisë
<i>Mus spicilegus</i>	P	Miu i stepës
<i>Rattus norvegicus</i>	P	Miu i murrmë i kanaleve
<i>Rattus rattus</i>	P	Miu i zi i kanaleve
RENDI CARNIVORA- FISSIPEDIA		
Fam. Canidae		
<i>Canis lupus</i>	0	Ujku
<i>Canis aureus</i>	P	Cakalli
<i>Vulpes vulpes</i>	P	Dhëpra
Fam. Mustelidae		
<i>Lutra lutra</i>	P?	Lundërza
<i>Meles meles</i>	P	Baldosa
<i>Mustela nivalis</i>	P	Nusc lalë
<i>Mustela putorius</i>	?	Qelbësi
<i>Martes foina</i>	P	Kunadhja

P- i pranishem; P?- potencialisht i pranishem; ? - prania e dyshimte; 0 - lloj rastesor.

Shpendet e pranishem ne zone jane lloje tipike te habitateve rurale dhe peisazheve antropogjenike. Me te zakonshmit jane shpendet e rendit te harabeloreve (*Passeridae*) si harabeli i shtepise (*Passer domesticus*), gardalinat (*Carduelis chloris*, *Carduelis carduelis*), sorra (*Corvus corone*), laraska (*Pica pica*), mellenjat (*Turdus sp.*), bishtatundesit (*Motacilla sp.*). Gjithashtu, me shumice haset kumria (*Streptopelia decaocto*) dhe nder llojet veruese qyqja (*Cuculus canoris*) dhe pupeza (*Upupa epops*).

Llojet grabitqare jane pergjithesisht te rralle, nder te cilet haset huta e zakonshme (*Buteo buteo*) dhe kukuvajka (*Athene noctua*).

Nga herpetofauna, llojet me te zakonshme jane breshkat e tokes (*Testudo hermanni*), hardhuca (*Podarcis muralis*), bullari (*Pseudopus apodus*), gjarpri i ujit (*Natrix natrix*) dhe lloje te ndryshme bretkosash (*Rana sp.*). Persa i perket iktiofaunes, paraqitet e varfer, per shkak te rrjetit hidrografik jo shume te pasur. Ne perroin e Gerdecit haset gjuca (*Alburnus sp.*) dhe ne rezervuaret artificiale vihet re prania e llojeve te peshqve te introduktuar, si ballgjeri (*Hypophthalmichthys molitrix*) dhe karasi (*Carassius carassius*).

Nje problem mjaft akut per faunen e zones, mbetet gjuetia e paligjshme dhe presioni njerezor. Pergjate ekspeditave dhe vezhgimeve ne terren u vune re shenja te

KONSULTIM ME PUBLIKUN
“DIFERENCIMI DHE TREGTIMI I SKRAPIT E MBETJEVE TE METALEVE TE
RICIKLUESHME”, VORE

vazhdueshme te gjuetise dhe nje densitet mjaft i larte gezhojash pergjate shtigjeve natyrore. Nga intervistat me banoret e zones kjo dukuri perbente nje problem madhor dhe shqetesim per natyren e vendit. Sipas banoreve, sezoni dhe rregullat e gjuetise nuk respektohen dhe prania me qendrat e medha si Durresi dhe Tirana e shton presionin nga gjuetaret ilegale dhe amatore. Me qellim qe objektivat per nje Vore me peisazh natyror terheqes dhe natyre clodhese te arrihen, duhen marre masa imediate kunder ketij fenomeni dhe zones i duhet dhene nje status mbrojtjeje ne rang lokal.

Zonat e mbrojtura

Ne Shqiperi, Zonat e Mbrojtura jane te konsideruara si pjese/siperfaqe e tokes dhe/ose ujit, detare/bregdetare, te destinuara kryesisht per konservimin e biodiversitetit, burimet natyrore dhe kulturore qe shoqerojne ate/ato dhe qe jane te menaxhuara ne menyre te ligjshme dhe/ose ne menyra te tjera efektive. Rrjeti i zonave te mbrojtura eshte bazuar ne kategorite e menaxhimit te IUCN dhe sistemi i ndertuar per kete qellim eshte ne perputhje me sistemin nderkombetar IUCN. Te gjashte kategorite e sistemit jane ekuivalente, te barabarta dhe te rendesishme dhe ato perfshijne te gjitha nivelet e nderhyrjes njerezore, te pranueshme per kategorine respektive. Krijimi i Zonave te Mbrojtura ka filluar qe ne vitin 1940. Ne 1981, per here te pare, asete te rralla natyrore u vendosen ne mbrojtjen shteterore duke shpallur si Monumente te Natyres pyjet me vlere shkencore, biologjike, historike dhe didaktike. Zona ne vleresim nuk vleresohet si zone me status te vecante nga MTM.

Zona nuk gezon ndonje status te vecante mbrojtje mjedisore dhe nuk perfshihet me rrjetin Kombetar te zonave te mbrojtura. Territori ne studim nuk eshte i perfshire ne menyre te drejtperdrejte ne zone te mbrojtur si rezervat, park kombetar etj. dhe nuk eshte zone e ruajtur ne perputhje me planet e zhvillimit ekonomik te vendit dhe ne strategjine kombetare te mjedisit. Nuk eshte zone e perdorur per specie te mbrojtura, te rendesishme te flores dhe faunes, si per kryqezim, folenizim, ushqim, pushim, dimerim, migrim qe mund te ndikohen nga zhvillimi i ketij aktiviteti.

Ashtu sikurse paraqitet ne hartën e meposhtme (burimi: ASIG), zona ne studim ndodhet ne largesi mbi 6 km nga Monumenti Natyror me i afert dhe mbi 11 km larg Zones se Mbrojtur Natyrore me te afert.

KONSULTIM ME PUBLIKUN
“DIFERENCIMI DHE TREGTIMI I SKRAPIT E MBETJEVE TE METALEVE TE
RICIKLUESHME”, VORE




Fig. Largesia nga Zonat e Mbrojtura Natyrore

Peizazhi ne zonen e Vores

Territori i bashkise se Vores bart vlera te vecanta natyrore dhe peisazhistike. Kjo vjen kryesisht si rrjedhoje e pozites gjeografike te Vores dhe relievit te saj. E ndodhur midis Durrësit dhe Tiranës, Vora dhe kodrat e saj paraqiten si nje oaz i gjelber ne mes te zhvillimeve te fuqishme urbane. Edhe pse nje nga nyjet me te rëndesishme te transportit te vendit dhe me mjaft industri tashme te stabilizuara, Vora, sidomos pjesa kodrinore e saj perben nje alternative zhvillimi mbi bazen e rekreacionit, peisazhit dhe natyres.

Brenda territorit te bashkise Vore nuk ka zona te mbrojtura te rangut kombetar si parqe kombetare, monumente natyre, rezervate natyrore apo te tjera te bazuara ne kategorite e Unionit Boteror per Ruajtjen e Natyres (IUCN), por gjithsesi mbetet per tu permendur se ekzistojne shume pak studime mbi vlerat e biodiversitetit dhe natyres se zones. Nisur nga vlerat peisazhistike dhe natyrore ne kontekstin rajonal dhe nga fakti qe territori i Vores ndodhet ne mes te qendrave me te medha te banuara te te gjithë vendit, ekziston potenciali i krijimit te parqeve natyrore rajonale me karakter rekreativ dhe clodhes.

KONSULTIM ME PUBLIKUN
“DIFERENCIMI DHE TREGTIMI I SKRAPIT E MBETJEVE TE METALEVE TE
RICIKLUESHME”, VORE

Pjese e identitetit natyror dhe peisazhistik te zones jane kodrat e pyllezuara - sidomos ne pjesen e fshatit Kuc dhe perreth Gerdecit – plantacionet e ullishtave shumevjecare dhe rezervuaret ujore, te cilet kane humbur rolin kryesor per ujitje dhe mund te transformohen lehte ne vende rekreacioni. Disa nga elementet me kryesore peisazhistike u evidentuan gjate ekspeditave ne terren nga grupi kerkimor i mjedisit: Territori i bashkise shtrihet me se shumti ne relief kodrinor, ku lartesite mbizoteruese jane Kodra e Gerdecit (295 m) ne veri dhe Kodra e Kucit (400 m) ne jug.

Peisazhi mbizoterues eshte ai agro-bujqesor me nderthurje te arave, plantacioneve frutore dhe ullishtave. Ullishtat (*Olea europaea*) perbejne nje element te spikatur, pasi paraqiten si te ruajtura mjaft mire nder vite dhe pertej kontekstit natyror bartin vlera historiko-kulturore per zonen.

Bimesia natyrore perbehet kryesisht nga shkurre mesdhetare dhe formacione te makjes (*Maquis*) me gjelberim te perhershem gjate gjithë vitit dhe formacione te dushkut (*Quercus sp.*).

Rezervuaret ujore; Gjokaj, Picar, Marikaj dhe Gerdec. Rezervuaret paraqesin disa nga resurset me te rendesishme dhe me te bukura qe ka bashkia per nga vlerat e peisazhit qe bartin. Peisazhi i cili krijohet perreth tyre eshte shume i bukur, dhe ka potencial te madh per tu shfrytezuar ne lidhje me zhvillim e turizmit liqenor dhe rekreativ.

Kodrat e vargut Gerdec – Kuc, paraqesin potencial per zhvillim si nje zone rekreacioni dhe ruajtjeje te natyres. Mbulesa e vegjetacionit natyror te nderthurur me peisazhet bujqesore, si edhe pamjet panoramike drejt Durresit dhe detit Adriatik nga perendimi dhe Tiranes dhe vargmalit Priske-Dajt nga lindja i japin zones karakterin e nje ‘ballkoni natyror’, menaxhimi dhe ruajtja e te cilit duhet te kete prioritet kryesor ne politikat e bashkise Vore.

Perpos vlerave te shumta, rajoni i bashkise Vore ka dhe shfaqjen e mjaft dukurive negative me impakt te thelle ne peizazhin natyror. Nder problematikat me kryesore dhe ndikimet negative ne peizazh mund te permendim:

Erozioni eshte i pranishem ne disa vende. Fenomeni i erozionit paraqitet problematik dhe gjate vizitave ne terren u evidentuan disa vende me erozion aktiv (psh. midis fshatrave Gjokaj dhe Kuc dhe ne Gerdec).

Shpyllezimi dhe demtimi i vegjetacionit natyral nga prerjet dhe kullotja intensive.

Kullotja e vazhdueshme me bageti te imta u konstatua si aktivitet i perhapur dhe qe ndikon drejtperdrejte ne shtimin e erozionit.

Zhvillimi i pakontrolluar urban dhe industrial pergjate rrugëve automobilistike (autostrada, rruga per ne veri). Vecanerisht ndertimet e pakontrolluara ne qytetin e Vores dhe prane tij mund te perbejne nje barriere peisazhistike per udhetaret dhe vizitoret dhe cenojne vizionzhvillimin me te pershtatshem qe duhet te kete zona.

KONSULTIM ME PUBLIKUN
“DIFERENCIMI DHE TREGTIMI I SKRAPIT E MBETJEVE TE METALEVE TE
RICIKLUESHME”, VORE

3. INFORMACION PER PRANINE E BURIMEVE UJORE, NE SIPERFAQEN E
KERKUAR NGA PROJEKTI DHE NE AFERSI TE TIJ ZBATOHET
PROJEKTI

Zona ne studim gjendet mbi 1.4 km larg nga burimi uJOR me i afert, ashtu sic paraqitet dhe ne harten e meposhtme (burimi: ASIG). Ne vijim paraqitet rrjeti hidrografik i zones, ku vihet re se siperfaqja ne studim ben pjesen ne basenin e lumit Erzen.




Fig. Largesia nga burimet ujore te zones

Shqipëria zoteron burime të bollshme të ujit. Edhe pse sasitë janë të mjaftueshme për nevojat aktuale, cilësia e tyre shpesh është problem për shkak të ndotjes së tanishme dhe historike, sidomos në zonat e uletë fushore ku jeton pjesa më e madhe e popullsisë dhe ku zhvillohen pjesa më e madhe e aktiviteteve industriale dhe bujqesore. Problem tjetër mbetet shpërndarja jo e njëtrajtshme e burimeve ujore në vend. Burimet e përgjithshme, të ripërteritshme, të ujit në Shqipëri përdoren për qëllime urbane, industriale dhe bujqesore si edhe për sigurimin e prodhimit të energjisë elektrike nga hidrocentralet.

KONSULTIM ME PUBLIKUN
“DIFERENCIMI DHE TREGTIMI I SKRAPIT E MBETJEVE TE METALEVE TE
RICIKLUESHME”, VORE

Ujrat siperfaqesore dhe ato nentokesore jane te lidhur dhe varen nga njeri tjetri, por konsiderohen burime te ndara. Shqiperia ka gjashte lumenj te medhenj, ka liqene te medha nderkufitare dhe te lundrueshme, si dhe formacione te rendesishme ujembajtese, megjithate burimet ujore jane te shperndara ne menyre jo te barabarte ne vend. Ne vend ka hidrocentrale dhe rezervuare vaditjeje si dhe nje numer lagunash dhe mocalesh me vlere. Shqiperia renditet midis vendeve qe kane potenciale te medha me uje, baras me 8600 m³ per fryme ne vit. Derdhja mesatare vjetore e ujit ne det eshte 40,5 bilion m³, e cila korrespondon me nje derdhje prej 1300m³/sek. Reshjet jane nje burim i rendesishem i ujit me nje mesatare aktuale vjetore prej 1485 mm/vit. Burimet e ujerave siperfaqesor perdoren per prodhimin e energjise (hidro-energja), industri dhe vaditje ku formacionet ujembajtese jane shume produktive dhe furnizojne me uje te pijshem shumicen e popullsisë urbane.

Uji perdoret ne te gjitha aspektet e jetes dhe eshte i rendesishem per perdoruesit publik dhe industriale. Si rrjedhoje e sistemeve te papershtatshme te monitorimit, ndryshimet e shpejta ne aktivitetet ekonomike dhe popullsi eshte e veshtire te vleresohet perdorimi i ujit ne terma te sakte.

Tabela. Vleresim i perafert i perdorimit te ujit ne Shqiperi

Perdorimi i Ujit	Volumi(bilion m³)
Hidrocentrale	14,0
Vaditje	1,013
626 rezervuare	0,560
Lumenj dhe Liqene	0,450
Uje Nentokesor	0,003
Uje i pijshem	0,22
Totali	16,246

KONSULTIM ME PUBLIKUN
"DIFERENCIMI DHE TREGTIMI I SKRAPIT E MBETJEVE TE METALEVE TE
RICIKLUESHME", VORE




Fig. Harte Baze e Baseneve Ujore ne Shqiperi

KONSULTIM ME PUBLIKUN
“DIFERENCIMI DHE TREGTIMI I SKRAPIT E MBETJEVE TE METALEVE TE
RICIKLUESHME”, VORE

Burimet ujore

Ne territorin e Bashkise Vore ndodhen kater rezervuare ujore, te cilat aktualisht perdoren informalisht nga banoret e zones per vaditje. Keto rezervuara perkatesisht ndodhen ne fshtatin Marikaj (2, me nje siperfaqe 78,000 m²) dhe ne fshatin Gjokaj (2, me nje siperfaqe 281,000 m²).

Aktualisht ato jane nje potencial i madh natyror si per zhvillimin e turizmit liqenor, duke i kthyer ato ne zona rekreative jo vetem per banoret e zones, por edhe me gjere.

Pershkrimi i Mjedisit

Gjendja ekzistuese e mjedisit

Territori qe ka nen administrim Bashkia Vore perben nje zone me mjaft interes nga pikepamja e vlerave natyrore dhe peisazhore. E gjendur ne mes te sistemit kodrinor Kepi i Rodonit – Vore – Ndroq, i cili ndan rajonin e Tiranes me ate te Durresit, Vora ka nje rendesi te madhe persa i perket ruajtjes dhe manaxhimit te hapësirave natyrore si kontrast i zhvillimeve masive urbane perreth saj. Ekspeditat e kryera nga grupi i mjedisit gjate periudhes ne fjale kane evidentuar elementet me karakteristike natyrore te territorit te Bashkise dhe potencialin e tyre ne kuader te zhvillimit te PZHTNJV.

Si pjese e rajonit Tirane- Durres, dhe kryqezim i rrugeve qe lidhin rajonin me portat dalese nderkombetare (Aeroporti i Rinasit dhe Porti Detar i Durresit), Vora shpalos potenciale te larta te zhvillimit ekonomik, social etj. Bashkia Vore ka nen administrimin e saj nje pjese te zonave industriale ne te dy anet e autostrades Tirane-Durres, ku zhvillojne veprimtarine shume fabrika te industrise se lehte te tipologjive te ndryshme. Kjo zone eshte me perspektive per rritjen dhe zhvillimin e metejshem te degeve te ekonomise dhe mundesi per hapjen e degeve te tjera. Per sa i takon problemeve mjedisore, Vora renditet ne ato qytete qe ka nje sere problemesh mjedisore, duke u nisur edhe nga vete pozita gjeografike qe ajo ka (afersia shume e madhe me autostraden).

Bujqesia dhe blegtoria

Territori i bashkise shtrihet me se shumti ne relievin kodrinor, ku lartesishte mbizoteruese jane Kodra e Gerdecit (295 m) ne veri dhe Kodra e Kucit (400 m) ne jug. Peisazhi mbizoterues eshte ai agro-bujqesor me nderthurje te arave, plantacioneve frutore dhe ullishtave. Ullishtat (*Olea europaea*) perbejne nje element te spikatur, pasi paraqiten si te ruajtura mjaft mire nder vite dhe pertej kontekstit natyror bartin vlera historiko-kulturore per zonen. Nder aktivitetet kryesore mbizoteruese te zones jane aktivitetet bujqesoren te tipit tradicional, qe konsistojne ne ferma me baze familjare me pronesi arash dhe bagetish te imeta. Perpos ullishtave, mjaft e perhapur eshte dhe vreshtaria.

KONSULTIM ME PUBLIKUN "DIFERENCIMI DHE TREGTIMI I SKRAPIT E MBETJEVE TE METALEVE TE RICIKLUESHME", VORE

Zona ne studim eshte pjese e Njesise se Qeverisjes Vendore Vore, Qarku Tirane dhe ka nje densitet popullsie prej 201 - 1000 banore/km².



Fig. NJQV ku ben pjese projekti




Fig. Dendesia e popullsisë

KONSULTIM ME PUBLIKUN
“DIFERENCIMI DHE TREGTIMI I SKRAPIT E MBETJEVE TE METALEVE TE
RICIKLUESHME”, VORE

- **Pershkrim i gjeologjise dhe hidrogjeologjise se Qarkut Tirane;**

- **Ndertimi gjeologjik**

Rajoni Tirane - Ishem ndertohet nga depozitime terrigjene te Paleogjenit, Neogjenit dhe Kuaternarit te cilat ndryshojne trashesine e tyre nga krahu lindor ne ate veriperendimor (shih Harten Gjeologjike te Zones Tirane – Ishem, shkalla 1:50000). Ne baze te studimeve me te fundit stratigrafike, depozitimet me te reja te bazamentit te ultesires Tirane-Ishem, jane ato te Miocenit. Ne ndertimin gjeologjik te ultesires ne fjale brenda rajonit te studiuar nga depozitimet qe dalin ne sipërfaqe ne ato te hapura me pus-shpime, marrin pjese kryesisht depozitimet e Eres Mesozoike dhe asaj Kenozoike duke filluar nga Sistemi i Kretakut, Paleogjenit deri ne ato te Kuaternarit, te cilat sipas perberjes litologjike mund te klasifikohen ne kater grupe:

- Formacioni karbonatik
- Formacioni flishor dhe flishoidal
- Formacioni mollasik
- Formacioni kuaternar

FORMACIONI KARBONATIK

Kretaku (Cr) Depozitimet karbonatike te Kretakut jane depozitimet me te vjetra qe zbulohen ne sipërfaqe ne zonen e studiuar. Keto depozitime takohen ne strukturen karbonatike te Makareshit e cila ben pjese ne zonen Tektonike Kruja. Ato karakterizohen nga ndryshime te theksuara faciale si dhe perfaqesohen nga gelqeroret e Kretakut te siperm Cr2 (gelqerore me rudiste dhe gelqerore te dolomitizuar) dhe gelqeroret e Eocenit Pg2 (gelqerore biomikritike dhe turbiditike) qe vendosen ne kontakt direkt me depozitimet e Miocenit te mesem N12.

Kretaku i siperm (Cr2)

Keto depozitime takohen ne strukturen karbonatike te zbuluar ne sipërfaqe, ne Makaresh. Gjithashtu ato jane takuar me puse kerkimi edhe nen depozitimet mollasike te depresionit Tirane-Ishem. Ne strukturen e Makareshit, pjesa e poshtme e prerjes perfaqesohet nga dolomite me nderthurje gelqerorësh dolomitike qe permbajne ne disa shtresa dhe rudiste. Me sipër prerja predominohet nga gelqerore dolomitike, me nderthurje me te rralla dolomitësh masive. Ne prerjen me te sipërme takohen dolomite me nderthurje gelqerorësh biokllastike shtresetrashe.

KONSULTIM ME PUBLIKUN
“DIFERENCIMI DHE TREGTIMI I SKRAPIT E MBETJEVE TE METALEVE TE
RICIKLUESHME”, VORE

Paleogjeni (Pg) Eoceni (Pg2)

Depozitimet paleogjenike qe ndajne sinklinalin Tirane-Ishem me Strukturen e Makareshit jane depozitimet e Eocenit te mesem Pg2, qe shtrihen transgresivisht mbi shkembinjte e Oligocenit Pg3 (Harta Gjeologjike e Shqiperise, 2002). Keto depozitime vendosen ne mospajtim stratigrafik mbi depozitimet e Kretakut te siperm ne Makaresh. Ne pushimin stratigrafik pothuajse takohet nje nivel boksitmbajtes i ndjekshem ne sipërfaqe. Litologjikisht ne pergjithesi keto depozitime perfaqesohen nga gelqerore biomikritike me makroforaminifere, shtrese mesem e me rralle shtrese trashe (Xhomo A., etj 2002).

FORMACIONI FLISHOR DHE FLISHOIDAL ze nje pjese shume te vogel te sipërfaqes se zones ne studim Tirane-Ishem duke u perhapur ne pjesen jugperendimore te takuar ne sipërfaqe me nje njolle te vogel ne jug te rajonit ne kodrat e Lalmit, Vaqarrit e Arbanes dhe ne pjesen lindore te saj ne formen e dy rripave te ngushte (Harta Gjeologjike e Shqiperise, 2002). Ky formacion perfaqesohet nga sistemet Paleogjen dhe Neogjen.

Paleogjeni (Pg) Oligocen i poshtem (Pg31)

Ne zonen tone depozitimet e Oligocenit te poshtem shtrihen ne krahun lindor te Makareshit dhe te antiklinalit te Dajtit. Ky seksion perfaqesohet nga flishi argjiloalevrolitoranor me horizonte vithisese dhe olistolite gelqeroresh (Harta Gjeologjike e Shqiperise, 2002). Ne kete zone pjesa e poshtme perfaqesohet nga pakujat mergelore kalimtare, me perberje litologjike pothuajse te njejte. Mbi pakon mergelore kalimtare, vijon suksesivisht flish i holle argjilo-ranor. Nga studimet tematike eshte verejtur se trashesia e ketij flishi rritet nga perendimi ne lindje, madje dhe brenda te njejtes strukture. Keshtu ne krahun perendimor te antiklinalit te Dajtit ajo eshte 250 m (prerja e Krujes), ndersa ne krahun lindor ajo i kalon 1000m. Ne vazhdim mbi flishin ranoro-argjilor me vithisje nenujore vendosen ranore masive, flish argjilo-ranor dhe vithisje nenujore dhe olistolite gelqeroresh. Trashesia e saj eshte 650m ne prerjen e Shupalit (Xhomo A., etj 2002).

Oligocen i siperm (Pg33)

Ne zonen tone depozitimet e Oligocenit te siperm shtrihen ne pjesen jugore te zones se studimit dhe perfaqesohen nga flish argjilo-ranor me shtresa gelqeroresh e ranore masive (Harta Gjeologjike e Shqiperise, 2002). Keto depozitime kane perhapje te kufizuar. Ato jane pjese e sinklinalit Paper-Rove. Depozitimet e kesaj moshe perfaqesohen nga flish argjilo-ranore, ranore masive, konglomerate, vithisje nenujore.

KONSULTIM ME PUBLIKUN
“DIFERENCIMI DHE TREGTIMI I SKRAPIT E MBETJEVE TE METALEVE TE
RICIKLUESHME”, VORE

Nga prerjet e kryera ne kete zone verehen ndryshime te theksuara litologjike. Keshtu ne sinklinalin e Paper-Rove prerja perfaqesohet nga nderthurje flishore me linza konglomeratesh e ranoresh. Ne pergjithesi depozitimet e Oligocenit te siperm vendosen normalisht mbi ato te Oligocenit te mesem ne Paper, Rove (Xhomo A., etj 2002) Neogjeni (N) Aquitani (N11 ne zonen Tirane-Ishem shtrihen ne pjesen jugore te saj dhe kane perhapje shume te vogel. Ne pergjithesi depozitimet e Aquitani kane marredhenie suksesive me depozitimet e nenshtrira. Ato perfaqesohen nga depozitimet ranore, alevrolite, argjila dhe konglomerate (Xhomo A., etj 2002). Ne shtrirje pesojne ndryshime te theksuara litologjike, duke kaluar ne flish ritem holle e deri ne argjila me horizonte vithesese.

Burdigaliani (N11 b) takohet ne pjesen jugore dhe jugperendimore ne zonen tone te studimit Tirane-Ishem. Keto depozitime shtrihen gjate gjithë kodrave te Lalmit (Harta Gjeologjike e Shqiperise, 2002). Depozitimet e Burdigalianit perfaqesohen nga mergele, argjila mergelore, alevrolite dhe gelqerore litotamnike e makroforaminifere (Xhomo A., etj 2002).

Langiani (N 12 1)

Ne zonen Tirane-Ishem depozitimet e Langianit perhapen ne formen e nje rripi te ngushte ne pjesen juperendimore te depresionit te Tiranes (Harta Gjeologjike e Shqiperise, 2002). Ato jane te mbivendosura dhe perfaqesohen nga nderthurje argjilash, mergele e ranore (Xhomo A., etj 2002). Formacioni mollasik vendoset transgresivisht me depozitimet me te vjetra te poshteshtruara dhe perfaqesohet nga mioceni i mesem (serrevaliani), Mioceni i siperm (tortonian-mesinian)-Pliocen (Harta Gjeologjike e Shqiperise, 2002).

Seravaliani(N12s)

Depozitimet e ketij kati kane perhapje siperfaqesore ne depresionin e Tiranes. Ato perhapjen me te madhe e kane ne qendren e sinklinalit te Pezes dhe ne gjithë faqen lindore te kodrave te Prezes, duke marre pjese ne ndertimin e monoklinalit te Prezes. Ato zhvishen gjithashtu si nje brez i ngushte edhe ne krahun lindor dhe ne centriklinalin jugor te depresionit Tirane-Ishem. Serravaliani, ne pjesen jugperendimore, sic shihet ne harte, shtrihet pa tregues te qarte te transgresionit, mbi formacionin shlior te Langianit, ndersa ne pjesen jugore, ai shtrihet transgresivisht mbi Burdigalianin. Me ne veri depozitimet e Serravalianit shtrihen transgresivisht dhe me diskordance te theksuar kendore mbi formacionet e zones se Krujes (Harta Gjeologjike e Shqiperise, 2002). Ne centriklinalin jugor dhe buzen lindore te

KONSULTIM ME PUBLIKUN
“DIFERENCIMI DHE TREGTIMI I SKRAPIT E MBETJEVE TE METALEVE TE
RICIKLUESHME”, VORE

depresionit te Tiranes prerja e Seravalianit dominohet nga ranore te trasha, kokrizemedhenj deri gravelitike, te nderthurur nga paketa alevrolitore. Pjesa e poshtme e saj ka dhe gelqerore litotamnike. Ne pjesen veriperendimore prerja gradualisht kalon ne alevrolit argjilor, me nderthurje shtresash gelqerori litotamnisk. Dallojme dy formacione te seravalianit:

- **Formacioni Mamli (N12s)**

Perfaqesohet nga alevrolite, argjila, konglomerate, ranore, ranore karbonatike, argjila karbonatike, si dhe kristale gipsi. Formacioni Krraba (N12s) Perfaqesohet nga ranore karbonatike, gelqerore ranorike, gelqerore litotamnike, alevrolite. Mioceni i siperm (N13) Ne depresionin Tirane-Ishem, depozitimet e Miocenit te siperm (N1 3) shtrihen ne pjesen juglindore, lindore dhe jugperendimore te tij. Ato perhapen nga miniera e Krrabes, ku formojne mbylljen centriklinale te depresionit, dhe vazhdojne ne Mushqeta deri ne Manez dhe ne lindje ne Skuterre-Priske e Burizane, duke ndertuar te dy krahet e depresionit (Harta Gjeologjike e Shqiperise, 2002). Nga ana litologjike depozitimet e ketij nenseksioni perfaqesohen nga alternime te njepasnjeshme midis pakove te trasha ranorike dhe atyre argjilo-alevrolitore (Xhomo A.,2002). Argjilat formojne paketa me trashesi 2-3 m deri 6-7 m dhe pergjithesisht jane alevritike. Kane ngjyre gri hiri deri jeshile te hapur, here-here me ndertim guaskor. Ne ranoret dhe alevrolitet e kesaj prerje vihet re nje shumice mbetje te lendes drusore, si dru te silicizuar dhe qymyre ne trajte linzash centimetrike deri shtresa te trasha industriale. Ne sipërfaqe, ne pjesen jugore te depresionit Tirane - Ishem keto depozitime vendosen transgresivisht mbi depozitimet e Seravalianit e ato me te vjetra . Ne krahun lindor te depresionit, megjithese gjate gjithe kontaktit me gelqeroret e antiklinalit te Dajtit marredheniet jane tektonike, ne esence ato kane qene transgresive. Kjo argumentohet me faktin e pranise se pullave te vecanta te ketyre depozitimeve ndermjet gelqeroreve. Sipas gjithë te dhenave te kompleksit gjeologogjeofizik me depozitimet e nenshtrira, ne thellesi, ato formojne ndertim te qarte dykatesor duke u vendosur ne trajten e nje monoklinali te qete mbi strukturat karbonatike e flishore te zones Kruja.

Tortoniani (N13 t)

Formacionet e Tortonianit ndertojne pothuajse te gjithe sinklinalin e Tiranes. Ne zonen e studimit Tirane-Ishem, depozitimet e tortonianit (N13t) shtrihen ne pjesen perendimore te tij (Harta Gjeologjike e Shqiperise, 2002). Depozitimet e Tortonianit (Xhomo A., etj 2002) si ne sipërfaqe dhe ne thellesi perfaqesohen nga dy litofacie: Litofacia ranoro-argjilore, e cila ka perhapje ne pjesen periferike te Ultesires Adriatike dhe te zones se Adriatikut Jugor, sidomos mbi orogjen e prane tij, si dhe litofacia

KONSULTIM ME PUBLIKUN
“DIFERENCIMI DHE TREGTIMI I SKRAPIT E MBETJEVE TE METALEVE TE
RICIKLUESHME”, VORE

argjiloranore qe takohet ne pjesen perendimore te Ultesires Adriatike dhe gjithë qendren e basenit. Kjo litofacie karakterizohet nga ranore e argjila te nderthurur dhe me gelqerore litotamnike te cilet jane depozitime te nje ambienti te ceket, kryesisht shelfore. Ranoret paraqiten me ngjyre gri te celur deri te zverdhur, ndersa ne thyerje te fresket kane ngjyre bezhe te erret. Jane kompakte, kokerrmedhenj, deri kokerrmesem. Trashesite e shtresave luhaten nga 0.5-1.5 m deri 5-6 m. Gelqeroret lithotamnike paraqiten ne trajten e shtresave me perhapje jo shume te madhe dhe me trashesi 2-3 m deri 7-8 m, ndonjehere permbajne shume litotamnie dhe makrofaune te llojeve te ndryshme. Keto te fundit takohen ne pjesen e siperme te tyre, kur litologjikisht kalojne ne argjila alevrolitore. Ndersa litofacia tjeter argjilo-ranore karakterizohet nga depozitime te nje ambienti te thelle. Karakteristike e litofacies se dyte eshte se trupat ranore jane te tipit linzor, me perhapje te kufizuar dhe te formave gjenetike me teper kanalore. Ne pjesen veriperendimore te depressionit, depozitimet e Tortonianit vendosen suksesivisht mbi ato te Seravalianit. Dallojme kater formacione te Tortonianit:

Formacioni Priska (N13t) – fillon me nje horizont konglomeratesh ose brekcesh bazale. Pjesa e poshtme e prerjes perfaqesohet nga ranore shtrese trashe, masive, me ndershtresa alevrolitesh ose ranoresh gravelitike te kuqerremte. Ne pjesen e mesme te prerjes shtohen ndershtresat alevrolite mes ranoreve, ndersa ne pjesen e siperme shfaqen gelqeroret rifore, kryesisht litotamnike, te cilet drejt veriut pykezohen. Ne sektorin qendror – jugor, mbi ranoret gravelitike te kuqerremte vijojne nderthurje argjilo – alevrolitiko – ranorike me qymyre e stome ostreash. Ne malin e Dajtit drejt Priskes mbi boksite kemi konglobrekce, gelqerore, etj.

Formacioni Skuterra (N13t) – perfaqesohet nga nderthurje paketash te trasha argjiloro – alevrolitike, ngjyre hiri te kalter, me ndershtresa te rralla ranoresh polimikte kokrrize imet-mesem deri gravelitike ne pjesen e poshtme. Mes argjilave takohen ndershtresa te rralla qymyresh te murme dhe rreshpesh qymyrore – argjilore dhe stome organogjene (kryesisht me ostrea).

Formacioni Iba (N13t) – ranore shtrese trashe deri masive me shtresezim te gershetuar. Rralle ndershtresa e thjerza gravelitike. Ngjyra e ranoreve verdhacake e celet, paksa e kuqerremte. Kemi te bejme kryesisht me ranore polimikte kuarc – felshpatike, kokrrize trashe- mesem me cimentim te dobet (“shtufore”). Ne ranoret rralle ndeshen dhe copa druri te gurezuar. Shume rralle ne pjesen e siperme takohen dhe ndershtresa argjilore, alevrolitike e mergelesh si dhe qymyre te murrme e rreshpe qymyrore.

Formacioni Mezezi (N13t) – perfaqesohet nga ranore te ngjashem me te Ibes ne pjesen e poshtme te pjeses veriore te rajonit qe ne pjesen jugore dhe qendrore kalojne facialisht ne alevrolite e argjila me ndershtresa te rralla ranorike. Me siper prerja e formacionit Mezezi eshte me nderthurje te argjilave ngjyre hiri – kalteroshe me alevrolito –

KONSULTIM ME PUBLIKUN
“DIFERENCIMI DHE TREGTIMI I SKRAPIT E MBETJEVE TE METALEVE TE
RICIKLUESHME”, VORE

argjiloro – ranore dhe ndershtresa te rralla ranoresh e alevrolitesh. Ne prerje ndeshen ndershtresa qymyresh te murme dhe rreshpe qymyrore – argjilore.

Mesiniani (N13 m)

Depozitimet e mesinianit ndertojne nje pjese te vogel te krahut perendimor te zones se studimit te cilat me ne veri vazhdojne deri ne Kepin e Rodonit. Nga ana litologjike ekzistojne dy litofacie, duke pasqyruar pak a shume te njejten histori zhvillimi si ne Tortonian. Ne kete pjese te zones takohet litofacia ranoro-argjilore. Kjo litofacie ranoro-argjilore perfaqesohet nga nderthurje paketash ranorike me paketa argjila-alevrolitore. Ranoret predominojne ne prerje dhe paraqiten ne trajten e paketave me trashesi 6-7m deri 15- 20. Ne pergjithesi jane kokerndryshem, me shtresezim te pjerret dhe ralle here verehen dhe zaje te vegjel midis ranoreve. Ne rajonet ku prerja dominohet nga ranoret, sidomos gjate buzes anesore te Ultesires Adriatike, takohen dru te fosilizuar, mungon facia gipsmbajtese dhe prerja deri ne tavan eshte krejt ranorike. Argjilat kane pamje me teper alevrolitore dhe paraqiten me ngjyre gri hiri. Midis tyre takohen disa horizonte makrofaune te tipit kryesisht ostrea, te ndjekeshme ne distanca te medha. Litofacia argjilo-ranore, ndryshe nga ajo ranoro-argjilore, karakterizohet per nje ambjent te thelle ku ne pergjithesi predominojne argjilat. Argjilat paraqiten ne trajten e paketave te trasha, dhjetra metroshe te cilat ne drejtim te lindjes kalojne dora-dores ne argjila jo te pasterta deri ne alevrolite. Ranoret paraqiten shtresore, por me perhapje te kufizuar, dhe te tipit linzor te formave gjenetike kryesisht kanalore. Me siper vihet re se prerja behet me ranorike, gje qe lidhet me ciklin regresiv te sedimentimit.

Plioceni (N2)

Ne zonen tone te studimit, depozitimet e pliocenit perfaqesohen nga plioceni i poshtem (N2 1-h) i cili zbulohet ne sipërfaqe ne veri, ne zonen e Mamurrasit (Harta Gjeologjike e Shqiperise, 2002). Depozitimet e formacionit "Helmasi" fillojne me shfaqjen ne prerje te shtresave ranore dhe konglomerateve te pangopur, qe percaktojne dyshemene e tij dhe njekoheesisht shenojne pranine e transgresionit pliocenik. Formacioni Helmasi (N2H) – mund te konsiderohet edhe si grup formacional, ndahet ne tre pako litologjike qe nga poshte lart jane: Pako ranoro-konglomeratike N2H(a)- perfaqesohet ne pjesen e poshtme nga depozitime ranoro – konglomeratike bazale. Konglomeratet jane te pangopur dhe shprehin fillimin e transgresionit te Pliocenit. Konglomeratet jane disi te cimentuar dhe te nderthurur me argjila e ranore. Ranoret jane shtresore, kokerr medhenj – kokerr mesem, me ngjyre gri ne bezhe, disi kompakte. Prerja ndiqet siper me argjilo – ranore. Pako argjilo-

KONSULTIM ME PUBLIKUN
“DIFERENCIMI DHE TREGTIMI I SKRAPIT E MBETJEVE TE METALEVE TE
RICIKLUESHME”, VORE

ranore dhe alevrolito-ranore N2H(b)- kryesisht mbizoterojne argjilat, te cilat jane jo shume kompakte deri te buta. Ngjyra hiri me permbajtje materiali alevrolitor. Ranoret jane kryesisht thejzore, te natyres kanalore, me trashesi te thjerrzave 20 – 30m e me shume, kokrriz vogel – mesem dhe kokerr medhenj, disi kompakte, ngjyre hiri bezhe. Alevrolitet jane masive deri shtresore, kompakte, ngjyre bezhe. Pako argjiloro-alevrolitike N2H(c)- argjilo alevrolitet jane kompakte, ngjyre gri, hiri bezhe. Ne argjilat eshte karakteristike thyerja guackore deri ciflore e vende vende shtresore me permbajtje makrofaune. Ne brendesi te pakos takohen edhe thjereza te rralla ranorike kanalore.

DEPOZITIMET KUATERNARE

Jane te perhapura ne te gjithe luginen e Tirane- Ishmit gjate shtratit te lumenjve e perrenjve kryesore rreze kodrave si dhe shpatet malore (Harta Gjeologjike e Shqiperise, 2002). Midis tyre dallojme depozitimet aluviale, lagunore si dhe depozitime te perziera aluvialeproluviale te cilat jane me te perhapura dhe me te rendesishme ne kete rajon.

Depozitimet proluviale (Qp-h)


Keto depozitime kane perhapje te kufizuar, perhapen kryesisht ne pjesen jugore, juglindore, lindore dhe me pak ne pjesen perendimore te rajonit Tirane-Ishem (Harta Gjeologjike e Shqiperise, 2002). Ato ne pergjithesi perfaqesojne depozitimet e formuara nga perrenjte qe derdhen ne luginat e lumenjve kryesore (Xhomo A., etj 2002). Kryesisht ato jane te sotme dhe kane formen e freskoreve deri ne formen e koneve te rrjedhjeve. Ato formohen nga materialet e kores se prishjes se formacioneve ose nga copra te shkembinjve dolomitike te cilet grumbullohen rreze kodrave e maleve ne forme brekcie – shpatore, suargjile e surere dhe zhure e guraleca te paseleksionuar dhe te parrumbullakosura mire.Trashesia e pergjithshme e tyre arrin 3.0 – 8.0 m. Ne drejtim te veriperendimit ato kalojne ne depozitime aluviale.

Depozitimet aluviale (Qh)

Shtrihen ne nje siperfaqe te madhe te ultesires dhe duke filluar nga Tirana, ato vazhdojne te shtrihen ne veriperendim ne Rinas, Fushe-Kruje dhe deri ne Ishem. Ato mbulojne kudo pjesen qendrore te ultesires sidomos taracat e luginat e lumenjve dhe meandrimet e shtratit te tyre te formuara gjate kohes kuaternare (Harta Gjeologjike e Shqiperise, 2002). Kane perhapje te gjere ne rrjedhjet e mesme te lumenjve. Ne rrjedhjet e mesme dhe te siperme ato formojne depozitimet e taracave te shtratit si dhe depozitimet e sotme te shtratit, te cilat i perkasin Holocenit te vonshem. Keto

KONSULTIM ME PUBLIKUN
“DIFERENCIMI DHE TREGTIMI I SKRAPIT E MBETJEVE TE METALEVE TE
RICIKLUESHME”, VORE

depozitime kane qene dhe jane objekt i shfrytezimit te inerteve, pasi kryesisht perfaqesohen nga zhavorre, zhurre dhe rera. Keto depozitime i takojme ne lumenjte duke filluar nga lumi i Tiranes, Terkuzes, Zezes e Drojes. Ne fushen e Tirane-Ishmit dallojme edhe aluvionet e nivelit te taraces se pare te takuar ne zonen Mezez- Ishem, te cilat i perkasin Holocenit te hershem, dhe ato te Holocenit te vonshem qe i takojme ne grykederdhjen e Ishmit dhe i perkasin nivelit te taraces seshtratit. Ato kryesisht perfaqesohen nga alevrite, rera te imta dhe me pak nga argjila. Shtrihen ne nje siperfaqe te madhe te ultesires duke filluar nga Tirana, ato vazhdojne te shtrihen ne veriperendim ne Rinas, Fushe-Kruje dhe deri ne Ishem. Sipas perberjes litologjike ato perbehen nga rera-zhavorrore me kokrriza e zaje te ndryshme qe mbulohen nga siper prej subargjilave ose subrerave ngjyre kafe ne te verdhe te shkrufta e poroze dhe me permbajtje guralecesh e okside hekuri (Xhomo A., 2002). Ato dallohen nga paqendrueshmeri e madhe dhe nga ndryshime te shpeshta e te menjehershme te trashesise se tyre qe ne drejtim te veriperendimit nga Tirana ne Laknas mer respektivisht vlerat 5.5 m, 20.0 m deri ne 75 m. Ndersa ne zonen Fushe- Kruje- Mamurras, trashesia e tyre rritet nga lindja per ne perendim duke arritur vlerat nga 20.0 m ne 101.0 -119.0 m. Po gjithashtu ne keto drejtime peson rritje edhe trashesia e mbulses subargjilore e cila merr vlera me te medha 60.0-80.0 m. Shtresa rero-zhavorrore e kuaternarit paraqitet me ujembajtje te konsiderueshme dhe me e pasura me ujera nentokesore kete rajon prandaj pershkrimi i saj ne vecanti edhe ne menyre te detajuar jepet ne kushtet hidrogeologjike te zones.



KONSULTIM ME PUBLIKUN “DIFERENCIMI DHE TREGTIMI I SKRAPIT E MBETJEVE TE METALEVE TE RICIKLUESHME”, VORE




Fig. Harta gjeologjike e Qarkut Tirane




Fig. Harta hidrogjeologjike e Qarkut Tirane

KONSULTIM ME PUBLIKUN
“DIFERENCIMI DHE TREGTIMI I SKRAPIT E MBETJEVE TE METALEVE TE RIKIKLUESHME”, VORE

Siperfaqja e synuar per zhvillim gjendet ne nje zone te pershtatshme per ndertim, ashtu sikurse ilustruhet nga harta e meposhtme (burimi: ASIG).




Fig. Harta e zonimit gjeologjik te Qarkut Tirane




Fig. Harta e rrezikut gjeologjik te Qarkut Tirane

KONSULTIM ME PUBLIKUN
“DIFERENCIMI DHE TREGTIMI I SKRAPIT E MBETJEVE TE METALEVE TE
RICIKLUESHME”, VORE

Klima

Zona ne studim perfshihet ne zonen klimatike mesdhetare fushore te Shqiperise. Kjo zone karakterizohet nga dimer te bute dhe te laget dhe vere te nxehte dhe te thate.




Fig. Harta e zonimit klimatik te Shqiperise

Vleresimi i vecorive klimaterike te rajonit eshte bere duke u bazuar ne te dhenat shume vjecare te vrojtuar ne stacionet meteorologjik i Kamzes dhe Sukthit. Klima e rajonit te Tiranes eshte mesdhetare e karakterizuar nga nje vere e nxehte dhe relativisht e thate si dhe me dimer te ftohte dhe te lagesht. Per shkak te veprimtarise se gjere ciklonare sasia me e madhe e reshjeve vihen re ne gjysmen e ftohte te vitit, dhe ajo me e ulet ne periudhen e ngrohte te tij. Zona ne studim eshte nje nga zonat qe karakterizohet nga sasi reshjesh vjetore te ulta mesatarisht 931mm ne vit te cilat bien kryesisht ne forme shiu. Muaji me me shume reshje eshte muaji nentor (132.9 mm), i ndjekur nga muaji dhjetor (113 mm).

KONSULTIM ME PUBLIKUN
“DIFERENCIMI DHE TREGTIMI I SKRAPIT E MBETJEVE TE METALEVE TE
RICIKLUESHME”, VORE

Muaji me me pak reshje eshte muaji korrik me 23.9 mm. Numri I diteve me reshje ≥ 1.0 mm varion nga 2.4 dite (korrik) deri ne 11.1 dite (dhjetor). Gjate vitit ka mesatarisht 86.4 dite me reshje ≥ 1.0 mm.

Zona ne studim nuk klasifikohet si zone me sasi te medha reshjesh 24-oreshe, ose me mire ajo ben pjese ne zonat ku shirat jane me pak te rrembyeshem. Megjithate nuk perjashtohen edhe rastet kur sasia maksimale 24-oreshe ka arritur 180.8mm dhe 182.5mm perkatesisht ne muajt nentor dhe tetor. Ndersa maksimumi 24h per periudhen 30 vjecare varion nga 43.0 mm ne korrik (per vleren me te ulet) deri ne 182.5 mm ne tetor te vitit 2002.

Rreshjet jane nje element i rendesishem meteorologjik, qe ne rajonin e Tiranës dhe Durresit kryesisht perfaqesohen nga shiu. Ne tabelen me poshte paraqitet sasia e rreshjeve sipas muajve dhe numuri i diteve me rreshje gjate vitit bazuar ne te dhenat shume vjecare meteorologjike.

Sasia e reshjeve mujore dhe numri i diteve me reshje gjate vitit bazuar ne te dhenat shume vjecare meteorologjike

Muajt		01	02	03	04	05	06	07	08	09	10	11	12	Vjetor
Reshjet														
Reshjet mujore mm		112	98	86	60	57	28	12	20	35	131	164	150	983
Max 24 oresh mm		89	83.6	63	66.1	67	77	35	65.3	72.3	182.5	180.8	59	1042.6
Numri i diteve me reshje	0.1 mm	13.3	11.5	10.7	8.8	7.5	4.9	3.5	3.5	5.7	10.7	12.4	14.4	106.9
	5 mm	6.1	5.5	5.1	3.5	3.3	1.8	1.0	1.5	2.5	5.4	8.5	7.2	51.4
	10 mm	4.2	3.3	2.7	1.9	1.9	0.9	0.5	0.9	1.6	3.6	5.5	4.1	31.1

Temperatura e ajrit

Ne rajonin e Tiranës, temperatura e ujit eshte me e larte ne muajet e veres (Korrik - Gusht), ku edhe sasia e energjise diellore eshte me e madhe, ndersa temperature me e ulet eshte ne dimer, ne muajin Shkurt. Persa i perket vecorive sezonale mund te pohojme qe gjysma e ngrohte e vitit prill-shtator karakterizohet nga temperature mesatare 20.6°C ndersa gjysma e ftohte 12.4 °C. Ecuria vjetore e temperaturave maksimale absolute te ajrit eshte e njejte me ate te temperaturave mesatare, pra me nje minimum ne janar dhe maksimum ne Korrik ose Gusht.

KONSULTIM ME PUBLIKUN
“DIFERENCIMI DHE TREGTIMI I SKRAPIT E MBETJEVE TE METALEVE TE
RICIKLUESHME”, VORE

Temperaturat maksimale absolute >30°C fillojne te regjistrohen qe nga muaji Maj dhe vazhdojne deri ne Shtator. Temperatura maksimale absolute me e larte e vrojtuar eshte 39.0°C ne Korrik (viti 2007).

Nje nga treguesit me te rendesishem per te karakterizuar temperaturat maksimale te ajrit eshte dhe mesatarja maksimale, vlerat e se ciles variojne nga 12°C ne Janar deri ne 27.8°C ne Korrik.

Minimumi absolut i tyre arrihet ne muajin Janar (-6.0°C). Por duhet permendur gjithashtu duke vlera te ulta te ketij treguesi jane vrojtuar qysh ne Nentor (-1.6°C) deri ne muajin Mars (-5.2 °C).

Kjo zone, ashtu si edhe ne rastin e rrezatimit diellor, karakterizohet nga nje numer i madh i oreve me diell. Mesatarisht gjate vitit ka 2655 ore me diell, me vleren me te larte ne korrik me 355 ore dhe ate me te ulet ne dhjetor me 107 ore.

Temperatura pergjate vitit ne zonen e Tiranes

Mujore		01	02	03	04	05	06	07	08	09	10	11	12
Temperatura													
Mesatare 0C		7.9	8.8	11.0	14.4	18.1	21.9	24.0	23.9	21.4	17.6	13.7	10.0
Mesatarja mujore	Me e larta	-11.6	11.7	14.2	16.6	20.7	23.8	26.2	25.8	24.0	20.2	15.8	12.1
	Me e ulta	4.1	5.4	7.8	11.9	16.7	19.4	22.7	21.0	19.6	15.2	11.9	6.4
Max.absolute		18.8	22.1	24.9	28.6	31.3	35.0	37.7	39.0	34.0	32.2	26.0	21.7
Min.absolute		-7.4	-4.6	-3.0	2.4	6.2	11.0	13.6	11.0	8.2	5.0	2.0	-7.2

Djellezimi

Rajoni Tirane-Durres merr sasi te medha orresh diell. Vlera e zgjatjes vjetore te djellezimit levizne kufijte 2600-2700 ore.

Edhe numeri i diteve me diell leviz nga 320-330 dite. Vlerat me te larta jane vrojtuar ne korrik, 373 ore me diell, dhe me te ultat ne dhjetor 118 ore.

Edhe radiacioni diellor ndjek pothuaj te njejten shperndarje vjetore si dhe djellezimi. Energjia diellore mesatare gjate nje viti eshte 1600 kW ore/m², vleat me te larta jane

KONSULTIM ME PUBLIKUN
“DIFERENCIMI DHE TREGTIMI I SKRAPIT E MBETJEVE TE METALEVE TE
RICIKLUESHME”, VORE

vrojtuar ne korrik, 223.5 kW ore/m² dhe me te ultat ne dhjetor 52.9 kW ore/m². Ne tabelen e meposhtme jane dhene mesataret shumevjecare mujore te shperndarjes se djellezimit si dhe radiacioni diellor I pergjithshem.

Diellezimi (ore) dhe radiacioni diellor (kW h/m²)

Stacioni i monitorimit	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	Vjetore
Tirana	6.5	5.8	5.2	4.6	5.5	8.1	17.3	17.6	13.5	9.6	6.1	6.1	105.9
Kamez	5.7	5.5	4.7	4.6	5.7	8.0	16.2	16.0	12.3	9.6	5.6	6.1	100
Sukth	7.7	7.2	6.8	6.8	8.7	12.0	19.0	18.4	15.4	11.1	7.3	7.2	127.6

Vlera mesatare e diteve me re

Stacioni i monitorimit	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	Vjetore
Tirana	12.3	12.6	12.2	11.7	7.2	4.3	1.2	1.8	3.6	7.2	11.9	12.7	98.7
Kamez	12.4	10.9	10.3	9.9	6.1	3.9	0.8	1.4	2.3	6.3	11.0	11.6	86.9
Sukth	10.	10.2	9.2	7.6	4.6	3.3	0.7	1.3	2.9	5.0	9.7	10.6	75.1

Vlera mesatare e rrezatimit

Stacioni i monitorimit	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	Vjetore
Tirana	142.9	208.3	300	358.1	476.8	549.1	570	511	398.7	270	172.5	135.6	4093

Era

Ndikimi i detit Adriatik ne rajonin Tirane-Durres eshte i dukshem sidomos per sa i perket shpejtesise se eres dhe rregjimit te saj karakteristik gjate stines se veres. Ererat jane nje element mjaft i rendesishem per gjeografine dhe agro-metereologjine e rajonit. Kjo lidhet jo vetem me qarkullimin e pergjithshem te atmosferes por dhe me relievin dhe afersine e detit. Era ka karakterin e puhizes detare vecanerisht gjate sezonit te nxehte, dmth gjate dites era fryn nga deti ne toke, ndersa gjate nates nga toka ne drejtim te kundert. Drejtimi mbizoterues i eres ndryshon sipas stineve. Gjate

KONSULTIM ME PUBLIKUN
“DIFERENCIMI DHE TREGTIMI I SKRAPIT E MBETJEVE TE METALEVE TE
RICIKLUESHME”, VORE

periudhes se veres era dominuese fryn nga kuadranti i perendimit, nersa gjate periudhes se dimrit era fryn nga kuadranti i lindjes.

Intensiteti i eres sipas drejtimeve

Nr.	Elementet	Nr. Era	Drejtimi i eres							
			V	VL	L	JL	J	JP	P	VP
1.	Shperndarja vjetore e drejtimit 44ndustr (%)	11.9	27.5	2.9	4.3	16.7	8.2	4.7	12.5	8.1
2.	Shpejtesia mesatere(m/s)	–	3.3	2.4	3.5	4.5	6.7	5.8	4.9	4.4

Sic shihet periudhat pa ere perfaqesojne 11.9% te rasteve te pergjithshme te drejtimit 44ndustr. Duke ju referuar tabelës dhe trendafilit ndustr verejme qe drejtimi verior, N eshte mbizoteruesi me 27.5%, kurse vlerat minimale te rasteve jane sipas drejtimit verilindor NS me 2.9%. Mesatarja e shpejtesive sipas ketyre drejtimeve respektivisht jane: 3.3 dhe 2.4 m/s.

Mesatarja e shpejtesise se eres sipas stineve

Nr.	Stinet	Shpejtesi m/s
1.	Dimer (XII-I)	4.9
2.	Pranvere (III-V)	4.4
3.	Vere (VI-VIII)	3.9
4.	Vjeshte (IX-XII)	4.3
5.	Vjetore (I-XII)	4.4

Duke iu referuar tabelës se mesiperme shpejtesia mesatare ne stinen e dimrit eshte 4.9 m/s, ndersa mesatarja vjetore 4.4 m/s.

Ererat e forta qe fryjne sipas drejtimeve veri,N e juglindje SE me shpejtesi 40-45 m/s kane ne pergjithesi kohezgjatje te kufizuar, keshtu qe ndikimi I tyre ne rregjimin e valezimit eshte i vogel. Ererat me shpejtesi 10-20 m/s jo vetem kane rastisje me te madhe por kane dhe drejtim me te qendrueshem. Ne keto kushte shpejtesia e eres 20 m/s eshte perzgjedhur si shpejtesi per vleresimin e valeve maksimale llogaritese per qellime projektimi.

KONSULTIM ME PUBLIKUN
“DIFERENCIMI DHE TREGTIMI I SKRAPIT E MBETJEVE TE METALEVE TE
RICIKLUESHME”, VORE

Tokat e zones

Tokat bujqesore ne rajonin e Tiranes, kane pesuar transformime te konsiderueshme ne harkun kohor te njezet viteve te fundit, si pasoj e aktivitetit njerezor te pakontrolluar. Demtimi i zinxhirit te prodhimit bujqesor ne rajon ka prekur te gjithë elementet perberes se tij duke ndervepruar direkt mbi mjedisin ne teresi si dhe mbi jeten njerezore. Politikat territoriale te deritanishme nuk munden te ruanin nje zhvillim te qendrueshem ne Sistemin e Urbanizimit Urban - Rural, si pasoje e kerkeses per zhvillim ne hapsira sherbimi dhe banimi, formale dhe informale.

Sistemi i vaditjes se tokave bujqesore dhe sistemi i rezervuareve te rajonit si dhe nderlidhja e tyre me rrjetin e burimeve ujore jane demtuar rende nga mungesa e mirmbajtjes si dhe nga demtimet njerezore.

Sistemi i magazinimit perpunimit dhe nderlidhjes se tregjeve rajonale eshte inekzistent si pasoj e zhvillimit te pakontrolluar dhe ndryshimit te destinacionit te perdorimit te godinave pas privatizimit te tyre ne vitet 1990.

Siperfaqet e tokave bujqesore ne rajon u demtuan rende nga ndertimet formale dhe informale, duke ndryshuar eficencen e tyre ne shfrytezim dhe perdorim si dhe duke ndryshuar statusin e perdorimit te tokes.




Fig. Harta e perdorimit te tokes (toka bujqesore, zona te populluara para 1990, zona te populluara pas 1990)

KONSULTIM ME PUBLIKUN
“DIFERENCIMI DHE TREGTIMI I SKRAPIT E MBETJEVE TE METALEVE TE
RICIKLUESHME”, VORE

Rajoni ka nje numer te konsiderueshem tokash bujqesore te cilat jane me produktivitet te larte por me efence perdorimi te ulet.

Tektonika

Territori i Planshetit K- 34 - 100 (28- B) ben pjese ne Ultesiren Adriatike, e cila ndertohet nga formacione te fuqishme mollasike duke filluar nga Serravaliani, Tortoniani deri ne Pliocen. Ne pjeset anesore, sidomos aty ku vendosen mbi orogjenin depozitimet mollasike te Ultesires vendosen transgresivisht mbi vazhdimin e strukturave te zones Jonike dhe te zones Kruja (sinklinale i mbivendosur i Tiranes). Formacionet gjeologjike jane perfaqesuara nga depozitimet mollasike te Miocen - Pliocenit, pjese perberese e strukture monoklinale te Prezes. Mollasat e mbuleses fillojne nga Serravaliani, duke u ndjekur me lart nga Tortoniani, Mesiniani dhe Plioceni dhe se fundi edhe nga Kuaternari. Ato perfaqesojne nje monoklinal ne renie te shtresave kryesisht drejt perendimit, dhe vendosen mbi strukturat e zones tektonike Jonike.

Monoklinale i Prezes ndertohet nga depozitime te Miocenit Siperme - Pliocen, me renie kryesisht nga perendimi, 15 - 20°. Ne drejtim te jugut lidhet me sinklinalin e Pezes, i cili mbushet nga depozitimet e Serravalianit, Tortonian - Mesinianit e me te reja. Ky monoklinal ne skajin verior pritet nga tektonika terthore buze detit, tek Kepi i Rodonit, e cila e ka ulur nje pjese te Kalase se Skenderbeut nen ujerat e Adriatikut. Kjo shkeputje aktive ka qene edhe shkaku i perqendrimeve te termeteve ne kete zone. Ky rajon eshte zhvilluar si basen i thelle me zhytje te vazhdueshme deri ne fund te Miocenit dhe pa strukturen e dukshme para kesaj kohe. Periudha e shlireve (para mollasike), qe i perket Burdigalianit dhe Langianit, perfaqesohen nga material i imet terrigjen. Ultesira Mollasike Adriatike u krijua ne fillim te Serravalian (15 miloin vjet me pare), i takon pjeses se siperme te Miocenit te Mesem.

Gjate Serravalianit dhe Tortonianit kemi pasur te bejme me nje det te thelle, ku depozitimet perkatese jane formuar ne mjedis detar dhe turbiditik, ne fund te Tortonianit, levizjet epirogjenetike kane cuar ne cektezimin e detit, gati gati dhe daljen ne siperfaqe te bordit lindor te Ultesires Adriatike. Ne kete kohe kemi krizen “e Mesdheut per tharjen e detit”, formimin e kriperave ne nje mjedis lagunor. Kjo perkon me Mesinianin, ku formacionet e depozitimeve qe jane formuar ne bordin lindor te ultesires, perfaqesohen nga trupa te fuqishem ranorik te nderthur me argjila dhe alevrolite. Keto depozitime i perkasin kryesisht mjediseve te ceketa detare, deltor dhe lagunor.

Me vone deti pliocenik fillon te cektezohet, duke na formuar suiten Rrogozhina (me ne perendim te Ultesires Pranadriatike), qe perfaqesohet nga depozitime

KONSULTIM ME PUBLIKUN
“DIFERENCIMI DHE TREGTIMI I SKRAPIT E MBETJEVE TE METALEVE TE RICIKLUESHME”, VORE

konglomerate - ranorike te fuqishme te formuara ne mjedis te detit te ceket deltor - lagunor.

Ne fund te periudhes Pliocenike (1.6 milion deri ne 2 milion vjet me pare), kemi nje kompresion te fuqishem, qe deformon intensivisht edhe depozitimet Pliocenike, duke i nxjerre edhe ato mbi uje. Relievi i formuar ne fund te Pliocenit gjate periudhes se Kuaternarit pesoi ngritje te diferencuar sipas strukturave tektonike duke formuar kodra pergjate antiklinaleve dhe lugina pergjate sinklinaleve.

Ne fillim te Pliocenit te Mesem, qe perkon me regresionin e detit perhapet formacioni “Rrogzhina” qe perfaqesohet kryesisht nga konglomerate dhe ranore gravelitik e me pak argjila.




Fig. Harta skematike tektonike e Shqiperise

4. INFORMACION LIDHUR ME IDENTIFIKIMIN E NDIKIMEVE TE MUNDSHME, NEGATIVE, NE MJEDIS, TE PROJEKTIT

Sistemet e menaxhimit te mjedisit

Menaxhimi mjedisor eshte nje proces permes te cilit organizatat e ndryshme, percaktojne metodiken e vleresimit te demeve potenciale te ardhura nga aktiviteti qe ato kryejne dhe mbi kete baze te percaktojne masat qe duhet marre per minimizimin e tyre. Keto sisteme jane pjese e planit teresor te menaxhimit, perfshire strukturen e organizates, planifikimin e aktiviteve, pergjegjesite, praktikat, procedurat, proceset e punes dhe burimet e zhvillimit, implementimin e fazave te ndryshme te projektit, rezultatet, rivleresimet dhe punimet e mirembajtjes si edhe politikat mjedisore. Nje sistem i menaxhimit te mjedisit e lejon organizaten per kontrollin e ndikimeve ne mjedis, te ardhura si pasoje e aktivitetit te tyre. Vete ndermarrjet prodhuese kane standardet e tyre te brendshme lidhur me mbrojtjen e mjedisit. Keto standarde se bashku me ato nderkombetare kane sherbyer per krijimin e Sistemit te Standardeve te Menaxhimit te Mjedisit, ISO 14001.

1. Konsideratat baze te sistemeve te menaxhimit te mjedisit

Nuk mund te thuhet se ka nje rruge te qarte te implementimit te sistemeve te menaxhimit

mjedisor. Ceshtjet kyce te aplikueshme ne sistemet e menaxhimit mjedisor jane:

- Marrja e pergjegjesive: eshte hapi me i rendesishem ne zhvillimin e nje sistemi te suksesshem te menaxhimit mjedisor. Mbeshtetja e drejtuesve te kompanise mund te jete e drejtperdrejte ose permes hartimit te politikave te cilat percaktojne qarte pergjegjesite e kompanise lidhur me:
 - ✓ Respektimin e legjislacionit dhe kriterëve ligjore;
 - ✓ Parandalimin e ndotjes;
 - ✓ Permiresimin e vazhdueshem;
 - ✓ Objektivat e kompanise.
